



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 334 Akti

Nr. 420 Vendimi

Tiranë, më 13.7.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në datën 9.7.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Mirela Iliopullo**, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, komisioner Lulzim Hamitaj, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi në tërësi çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Iliopullo, e cila në seancën dëgjimore publike të datës 9.7.2021, kërkoi riçeljen e hetimit administrativ për kontrollin e figurës dhe për vlerësimin e aftësive profesionale,

VËREN:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Mirela Iliopullo, për shkak të funksionit si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016¹.
2. Pas hedhjes së shortit të datës 12.11.2019, trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Lulzim Hamitaj dhe Xhensila Pine, pasi administroi dhe shqyrtoi raportet e institucioneve të parashikuara nga nenet 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 19.11.2019, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktohet kryesues i trupit gjykues, komisionere Valbona Sanxhaktari. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
3. Në vijim të hapave hetimore, në datën 15.6.2021, me vendimin nr. 2, trupi gjykues, pasi vlerësoi ekzistencën e një niveli të lartë provueshmërie të provave të administruara, vendosi të mbyllë fazën hetimore dhe, në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, çmoi që procesi i rivlerësimit për znj. Mirela Iliopullo të bazohej vetëm në kriterin e pasurisë.
4. Në datën 16.6.2021, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën, brenda datës 28.6.2021; (iii) të njihet me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurës Administrative.
5. Më tej, në datën 21.6.2021, subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet *e-mail*-it, kërkoi kohë për zgjatjen e afatit për sjelljen e dokumentacionit dhe prapësimeve dhe trupi gjykues, me vendimin nr. 3, datë 23.6.2021, vendosi mospranimin e kërkesës së subjektit për zgjatjen e afatit të dërgimit të shpjegimeve dhe dokumentacionit mbështetës, pasi mund t'i paraqiste shpjegimet brenda afatit të përcaktuar, ndërkohë, për sa i takon dokumentacionit të mëtejshëm, mund t'i paraqesë deri në ditën e seancës dëgjimore.
6. Në datën 25.6.2021 është komunikuar nëpërmjet *e-mail*-it kërkesa e përfaqësueses ligjore të subjektit të rivlerësimit av. A. S. për nevojën e 15 ditë kohë për përgatitjen e mbrojtjes, duke cituar gjithashtu faktin se subjekti ishte në pritje të përgjigjeve dhe dokumenteve nga jashtë shtetit, duke kërkuar edhe riçeljen hetimit administrativ për dy kriteret e tjera. Trupi gjykues, me vendimin nr. 4, datë 25.6.2021, ka vendosur mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për riçeljen e hetimit, pasi në mungesë të provave të reja ende situata vijonte të ishte e njëjlojtë me atë kur u vendos mbyllja e hetimit mbi një kriter. Në vijim të rivlerësimit të situatës pas paraqitjes së prapësimeve, trupi gjykues do të mund të riçelte hetimin administrativ në varësi të risive që mund të konstatoheshin, të cilat mund të ndryshonin/zbehnin nivelin e provueshmërisë së rezultateve/gjetjeve të Komisionit. Gjithashtu, trupi gjykues, pasi analizoi kërkesën e av. A. S. për nevojën e një kohe shtesë, në frymën e kryerjes së një procesi të rregullt ligjor – në respektim të të

¹ Paragrafi 3 i nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", parashikojnë se: "Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*".

drejtave të palëve, dhe specifikuat atë të mbrojtjes së subjektit – vendosi shtyrjen e afatit të paracaktuar deri në datën 6.7.2021, me qëllim për të mundësuar përgatitjen e mbrojtjes për subjektin të rivlerësimit nga avokati kërkuar.

7. Në datën 7.7.2021 trupi gjykues mori në shqyrtim kërkesat e subjektit të rivlerësimit të komunikuar nëpërmjet *e-mail*-it të datës 6.7.2021, lidhur me administrimin e provave bashkëlidhur prapësimeve dhe riçeljen e hetimit për dy kriteret e tjera, atë të figurës dhe të vlerësimit profesional.
8. Në përfundim, trupi gjykues vendosi administrimin e të gjitha materialeve të përcjella me *e-mail* në datën 6.7.2021 dhe të mbërritura me postë në datën 7.7.2021, si dhe mospranimin e kërkesës për riçeljen e hetimit për dy kriteret e tjera, pasi nuk u konstatuan shkaqe të mjaftueshme, duke u rezervuar për ta çmuar sërish këtë mundësi riçelje, pasi të dëgjohej edhe mbrojtja e subjekti i rivlerësimit, znj. Mirela Iliopullo në seancë dhe të administrojë dokumentacionin e mëtejshëm që mund të paraqitej prej saj deri/përgjatë seancës së datës 9.7.2021.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Në seancën dëgjimore të datës 9.7.2021, subjekti u paraqit personalisht dhe me përfaqësuesen ligjore, av. A. S., të zgjedhur prej saj, të cilat shprehën qëndrimin e tyre, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, gjatë seancës dëgjimore, iu përgjigj pyetjeve të bëra nga trupi gjykues, si dhe shprehu qëndrimin e saj përfundimtar, duke kërkuar riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.
10. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, duke mos e vlerësuar të provuar të kundërtën e rezultateve që i ishin kaluar barrë prove subjektit, vendosi të konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin Mirela Iliopullo, duke u bazuar vetëm mbi kriterin e rivlerësimit të pasurisë. Seanca dëgjimore e datës 9.7.2021, u mbyll, për të rifilluar më 13.7.2021, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Znj. Mirela Iliopullo ka mbajtur qëndrim bashkëpunues me Komisionin, duke dhënë përgjigje të paraqitura në afatet e caktuara, si dhe ka vënë në dispozicioni edhe dokumentacion ligjor mbështetës, për aq sa ka disponuar, siç i është kërkuar nga Komisioni.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:
 - i. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”;
 - ii. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;

- iii. provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- iv. deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik me Komisionin (faqja 5 nga 33);
- v. shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, si dhe argumentimeve të bëra verbalisht nga subjekti në seancën dëgjimore të datës 7.6.2021;
- vi. deklaratimet e personave të lidhur, apo të tjerë të lidhur; si dhe
- vii. faktet e njohura botërisht.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

13. ILDKPKI-ja, bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Iliopullo, ku konstatohet se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

14. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49, dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

15. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; si dhe evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, parashikuar në pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

16. Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për rivlerësim kalimtar, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, janë si vijon:

1. Zyrë me sipërfaqe 44,99 m², ndodhur në lagjen “*”, Gjirokastër**

17. Pasuria e llojit “zyrë”, me sip. 44,99 m², ndodhur në lagjen “***”, Gjirokastër, është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2007, me vlerë 18.000 euro, me përshkrimin “dhënë paradhënie”, ndërkohë, në deklaratën *Vetting*, kjo pasuri është deklaruar si e përfituar me anë të kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 31.3.2009, kundrejt çmimit total prej 1.799.600 lekësh².

²Pasuri e llojit “zyrë” me sip. 44,99 m², me çmimin 40.000 lekë/m², e regjistruar me nr. pasurie ***, z. k. ***, e cila më pas, në vitin 2014, me aktmarrëveshjen nr. ***, datë 6.2.2014, midis subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortit të saj pas zgjidhjes së martesës, i ka kaluar në pronësi subjektit.

18. Nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2007 ka rezultuar se në datën 9.1.2009 subjekti i rivlerësimit ka paraqitur qartësime/plotësime lidhur me deklarimin e kryer prej saj në vitin 2007, duke bërë dy përshkrime shtesë, dhe konkretisht:
- a. Me palën shitëse “F.” sh.p.k. është lidhur kontrata e porosisë në maj të vitit 2006 dhe janë kryer pagesa për këstin e parë në shumën 5.400 euro, me burim krijimi: (i) kësti i parë nga kursimet e vitit 2005 dhe kursimet deri në prill të vitit 2006; (ii) kësti i dytë në shumën 9.000 euro në shkurt të vitit 2007, me burim nga kursimet e periudhës maj 2006 – shkurt 2007, duke deklaruar gjithashtu në rubrikën përkatëse detyrimin monetar në masën 3.600 euro të mbetur pa shlyer palës shitëse “F.” sh.p.k.³;
 - b. Subjekti i rivlerësimit është shprehur se gjendja *cash* në vitin 2006 është pakësuar në vitin 2007, në shumën 750.000 lekë. Lidhur me sa është deklaruar nga subjekti mbi gjendjen *cash*, nga shqyrtimi i DIPP- së nga vitit 2003 e deri në vitin 2007, Komisionit nuk i ka rezultuar të jetë deklaruar ndonjë kursim i disponuara *cash* nga subjekti i rivlerësimit, që të mund të konsiderohej si i pakësuar pikërisht në vitin 2007, sipas pretendimeve të saj.
19. Gjithashtu, ka rezultuar se në DIPP-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar shlyerjen totale të detyrimit të mbetur prej 3.600 euro në nëntor të vitit 2008, me burim krijimi nga kursimet nga të ardhurat e familjes dhe nga të ardhurat nga qiradhënia⁴. Nisur nga sa është përshkruar në shtesat plotësuese të DIPP-së së vitit 2007, lidhur me veprimin juridik të nënshkrimit të kontratës së porosisë në maj të vitit 2006, nga verifikimi i DIPP-së përkatëse rezultoi se nuk është deklaruar veprimi juridik i nënshkrimit të kontratës së porosisë dhe as kryerja e pagesës së këstit të parë prej 5.400 euro.
20. Referuar përmbajtjes së deklarimit të vetë subjektit në DIPP-në të vitit 2007, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar znj. Mirela Iliopullo të paraqesë kontratën e porosisë së vitit 2006, në përgjigje të së cilës është shprehur se nuk kujton të ketë nënshkruar ndonjë kontratë të tillë. Më tej ajo ka vënë në dispozicion një aktmarrëveshje të datës 27.2.2007, të nënshkruar nga administratori i shoqërisë shitëse, shtetasi A. P. dhe ish-bashkëshorti i subjektit J. K., në të cilën palët kanë rënë dakord për vlerën e shitjes së pasurisë së llojit “zyrë”, kundrejt vlerës 18.000 euro. Në këtë aktmarrëveshje është deklaruar gjithashtu se pala shitëse ka marrë nga blerësi J. K. edhe këstin e parë.
21. Nisur nga sa më sipër është deklaruar, dhe nga verifikimi i mandateve të pagesës së paraqitur nga subjekti, Komisionit i ka rezultuar se deri në datën e nënshkrimit të aktmarrëveshjes të sipërcituar, për këtë pasuri ishin likuiduar dy këste, e konkretisht, shuma 5.400 euro në datën 24.5.2006 dhe shuma 9.000 euro në datën 21.2.2007. Lidhur me mospërputhjen midis shumës së paguar prej 18.000 euro për blerjen e zyrës, referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe çmimit prej 1.799.600 lekësh të përshkruar në kontratën e shitblerjes së vitit 2009 dhe të deklaruar në deklaratën *Vetting*, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime, e cila nëpërmjet pyetësorit nr. 2 ka

³ Lidhur me ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesave të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë ndërtuese “F.” sh.p.k. dhe/apo ortakët e saj, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka rezultuar se janë dhënë 3 vendime³, të cilat rezultojnë të jenë dhënë pas përfundimit të marrëdhënieve të interesit me shoqërinë në vitin 2009. Me vendimin nr. ***, datë 31.5.2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur deklarimin e pafajshëm të të pandehurit A. P., për veprën penale “ekspertim i remë”. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, e cila me vendimin nr. ***, datë 14.7.2017, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe kthimin e kësaj çështjeje për rigjykim në po atë gjykatë, me një tjetër trup gjykues.

⁴ Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2007 dhënie me qira të zyrës organizatës politike LSI, pa ndërprerje, kundrejt vlerës prej 30.000 lekësh, e cila është depozituar në BKT.

bërë me dije se: “Marrëveshja paraprake për blerjen e zyrës ishte për shumën 18.000 euro dhe pagesat e kryera në lidhje me këtë kontratë kanë qenë 5.400 euro më 24.5.2006 dhe 9.000 euro më 21.2.2007. Vlera prej 18.000 euro ishte rënë dakord për zyrë të dorëzuar me të gjitha punimet e kryera. Duke qenë se nga ana e shoqërisë së ndërtimit nuk u përfunduan të gjitha punimet, u ra dakord që zyra do blihej e papërfunduar për vlerën 1.800.000 lekë dhe punimet e papapërfunduara do i kryenim vetë. Shumat e paguara prej nesh në totalin 14.400 euro, të konvertuar në 1.800.000 lekë dhe për pasojë ne nuk kemi kryer asnjë pagesë shtesë”.

22. Për të provuar sa më sipër, subjekti i rivlerësimit vuri në dispozicion deklaratën noteriale nr. ***, datë 5.3.2021, të lëshuar nga dy prej tre ish-ortakëve⁵ të shoqërisë “F.” sh.p.k.,
23. në të cilën kanë deklaruar se palët fillimisht kishin rënë dakord për çmimin 18.000 euro, për një objekt të përfunduar dhe se nga pala blerëse është paguar vetëm shuma prej 1.800.000 lekësh, duke qenë se objekti ishte dorëzuar i papërfunduar. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion edhe një faturë për furnizimin me energji elektrike të datës 18.2.2008, sipas së cilës ish-bashkëshorti ka kryer pagesat për lidhjen e re të instaluar në zyrë, çka tregon se, së paku në shkurt të vitit 2008⁶ familja e subjektit ka marrë në zotërim/dorëzim zyra nga shoqëria ndërtuese, ndërkohë që pagesa prej 3.600 euro është deklaruar nga vetë subjekti si e shlyer në nëntor të vitit 2008. Në këto kushte, në analizën financiare është konsideruar si e kryer pagesa e shumës totale prej 18.000 euro, si dhe shpenzimet e tjera për përfundimin e punimeve. Nga shqyrtimi dhe analizimi i dokumentacionit të disponuar nga Komisioni, si dhe të deklarimeve të vetë subjektit në DIPP-të ndër vite, është konstatuar se kontrata e shitblerjes së pasurisë është nënshkruar në datën 31.3.2009, ndërkohë që referuar deklarimeve të subjektit, shuma 18.000 euro është shlyer plotësisht në nëntor të vitit 2008.
24. Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, i ka kërkuar subjektit të bëjë me dije sa kanë qenë shpenzimet e kryera për përfundimin e punimeve në pasurinë, e cila, në përgjigje të sa më sipër, ka shpjeguar se punimet e kryera kanë qenë shtrimi me pllaka dhe pajisjet hidro-sanitare, të cilat në total kanë qenë në masën 50.000 lekë. Në mbështetje të deklarimeve të saj, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale të datës 16.4.2021, të lëshuar nga shtetasi D. Gj.⁷, i cili ka deklaruar se si përfaqësues i shoqërisë “D. Gj.” person fizik, në vitin 2008, ka blerë materialet dhe ka kryer punimet e ndërtimit në zyrën e shtetasit J. K.⁸ dhe se si kundërshtëpërblyer/kosto të punimeve të kryera është paguar nga ky i fundit vlera totale prej 50.000 lekësh⁹.
25. Në këto kushte, shpjegimet e subjektit mbi arsyen e diferencës së çmimit të blerjes së zyrës për shkak të punimeve të pakryera nga kompania ndërtuese dhe të pretenduara si të

⁵ Shoqëria ka pasur ortakët F. Ç. me 33,34% të aksioneve, F. H. me 33,33% të aksioneve dhe A. P. me 33,33% të aksioneve. Referuar ekstraktit të shoqërisë në www.qkb.gov.al rezulton se shoqëria është në likuidim e sipër prej datës 1.2.2010.

⁶ Qiradhënia e pasurisë në fjalë ka filluar nga data 1.3.2008.

⁷ Referuar shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.5.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, nuk rezulton të ketë vendime gjyqësore të dhëna nga kjo gjykatë në emër të shtetasit D. Gj.. Ndërsa për shtetasin S. Q. (identifikuar sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 16.4.2021, si shitës i pajisjeve elektroshtëpiake në vitet 2009 dhe 2012), Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2021, ka vënë në dispozicion 5 vendime gjyqësore me palë ndërgjyqëse shtetasin S. Q., i datëlindjes 1959, nga të cilat ka rezultuar se vetëm vendimi civil nr. ***, datë 29.6.2000, është dhënë nga subjekti i rivlerësimit, e cila ka qenë edhe kryetare e seancës.

⁸ Ish-bashkëshortit të subjektit.

⁹ Ndërkohë, nga kontrolli në faqen zyrtare të QKB-së, është konstatuar se kjo shoqëri është regjistruar pranë kësaj të fundit në datën 23.1.2015, pra shumë vite pas pretendimit të kryerjes së punimeve në fjalë në vitin 2008, çka duket se bie ndesh dhe nuk provon vërtetësinë e deklaramit të mësipërm si dhe të vlerës së shpenzimeve të pretenduara.

kryera nga vet subjekti nuk duken bindëse dhe veç të tjerash edhe për faktin se shuma e pretenduar prej 50.000 lekësh, si shumë e shpenzuar për këto punime të papërfunduara, është shumë më e ulët se diferenca prej 400.043 lekësh që rezulton midis çmimit të porositur prej 18.000 euro (konvertuar në 2.199.643 lekë¹⁰) dhe çmimit të blerjes në kontratën e shitblerjes të zyrës prej 1.799.600 lekësh. Nisur nga ky shkak, duke pasur në vëmendje dinamikën dhe kontradiktat e rezultuara midis deklarimeve dhe pagesave të kësteve përkatës, si dhe në mungesë të një logjike ekonomike, vlerësohet se kjo kontratë përmban një çmim fiktiv, duke përshkruar, në bashkëpunim me shoqërinë ndërtuese/shitëse, një vlerë më të ulët nga vlera reale e shitblerjes së pasurisë në fjalë.

26. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:

- i. ASHK-ja Gjirokastrë, me shkresën nr. *** prot., datë 27.2.2020,¹¹ si dhe me shkresën nr. *** prot., datë 16.12.2020¹², kanë konfirmuar se në emër të subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Iliopullo, figuron e regjistruar pasuria e llojit “njësi”, me nr. ***, me sip. 44,99 m², z. k. ***, regjistrim i bërë në bazë të deklaratës noteriale nr. ***, datë 6.2.2014; vendim nr. ***, datë 23.9.2013, për zgjidhjen e martesës së subjektit;
- ii. deklaratë noteriale nr. ***, datë 6.2.2014, midis subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortit të saj, pas zgjidhjes së martesës, sipas së cilës subjekti Mirela Iliopullo ka marrë, ndër të tjera, edhe pasurinë e paluajtshme zyrë, të ndodhur në lagjen “****”, Gjirokastrë; vërtetim hipotekor nr. ***, datë 18.12.2014, në emër të subjektit të rivlerësimit;
- iii. FSHU-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 4.2.2020, ka bërë me dije se në emër të subjektit të rivlerësimit nuk rezulton të ketë kontratë furnizim me energji elektrike; UKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 18.2.2020, ka informuar se për shtetasen Mirela Iliopullo dhe personat e lidhur nuk rezulton asnjë e dhënë për kontratë për shërbimin e ujësjellës-kanalizimit;
- iv. deklaratë noteriale nr. ***, datë 5.3.2021, e lëshuar nga shtetasit A. P. dhe F. Ç., të cilët kanë deklaruar në cilësinë e përfaqësuesve të shoqërisë “F.” sh.p.k. se kanë lidhur një aktmarrëveshje në datën 27.2.2007 me shtetasin J. K., për çmimin e shitjes prej 18.000 euro dhe se nga pala blerëse është paguar çmimi prej 1.800.000 lekësh, meqenëse ambienti është dorëzuar në gjendje të papërfunduar dhe se punimet e mbetura do të bëheshin nga vetë blerësi;
- v. mandatarkëtimi i datës 24.5.2006 për derdhjen e këstit të parë në shumën 5.400 euro dhe mandatarkëtimi i datës 21.2.2007, për pagesën e këstit të dytë në shumën 9.000 euro, nga shtetasi J. K..

Analizimi i burimeve të krijimit për blerjen e kësaj pasurie

27. Lidhur me analizimin e burimit të kësaj pasurie subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat periodike si burim të krijimit të ardhurat si vijon:

- i. kësti i parë në vlerën 5.400 euro është paguar në maj të vitit 2006, me burim nga kursimet e vitit 2005 dhe kursimet deri në prill të vitit 2006;
- ii. kësti i dytë në vlerën 9.000 euro është paguar në shkurt të vitit 2007, me burim krijimi nga kursimet gjatë periudhës maj 2006 – shkurt 2007;

¹⁰ Sipas kursit mesatar të fundvitit 2006, 2007 dhe 2008, për secilën prej pagesave të kryera.

¹¹ Në përgjigje të kërkesës së Komisionit me nr. *** prot., datë 27.1.2020.

¹² Në përgjigje të kërkesës së Komisionit me nr. *** prot., datë 5.10.2020.

- iii. kësti i tretë në shumën 3.600 euro është paguar në nëntor të vitit 2008, me burim nga kursimet e familjes dhe të ardhurat nga qiraja¹³.
28. Nga shqyrtimi dhe analizimi i deklarimeve të subjektit në DIPP-të ndër vite, Komisionit i ka rezultuar se subjekti ka deklaruar kursime të disponuara *cash* për herë të parë vetëm në DIPP-në e vitit 2008, ndërkohë, sikurse është cituar edhe më lart, ka deklaruar pakësimin e kursimeve të disponuara në fund të vitit 2006, prej 750.000 lekësh.
29. Lidhur me deklarimin e pakësimit të gjendjes *cash*, Komisioni ka ftuar subjektin e rivlerësimit të japë shpjegimet e saj, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, në përgjigje të së cilit ka shpjeguar se: *“Kur kam plotësuar deklaratën e vitit 2003, nuk e kisha kuptuar se duhet të përfshiheshin në deklaram edhe kursimet e mbajtura në shtëpi. Kjo edhe për faktin se nuk kishte udhëzime dhe trajnime në lidhje me mënyrën e plotësimit të kësaj deklarate. Këtë gjë e kam kuptuar vite më vonë gjatë një bisede me një kolege dhe në vazhdim kam përfshirë në deklaramet e mia edhe kursimet familjare. Saktësoj se kur them kursimet e vitit 2005 kam parasysh kursimet deri në fund të vitit 2005, përfshirë edhe vitet paraardhëse. E njëjta gjë edhe për vitin 2006 e 2007. Pra, në këndvështrimin tim kursimet i kam trajtuar si progresive dhe jo të ndara sipas periudhave. Nuk mund të përcaktoj ekzaktësisht sa ishin kursimet e secilës periudhë, por të ardhurat që kanë shërbyer për këto kursime janë nga paga ime dhe e ish-bashkëshortit”*.
30. Për të provuar sa më sipër, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor mbi të ardhurat e saj dhe të ish-bashkëshortit, si vijon:
- i. vërtetim nr. *** prot., datë 2.3.2021 nga ISSH-ja Sarandë, për verifikimin e vjetërsisë në punë të ish-bashkëshortit të subjektit¹⁴; vërtetim nr. ***, datë 1.3.2021, nga Komisariati i Policisë Sarandë, e cila ka bërë me dije se nuk ka asnjë dokumentacion për të ardhurat e ish-bashkëshortit të subjektit, pasi i gjithë dokumentacioni për periudhën përpara 16.2.1997 është djegur gjatë trazirave;
 - ii. vërtetim nr. *** prot., datë 3.3.2021, nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë, e cila ka bërë me dije se për periudhën 1.1.1985 – 31.12.1990 nuk disponon listëpagesat, pasi janë djegur;
 - iii. vërtetim nr. *** prot., datë 24.2.2021, për të ardhurat e përfituara nga subjekti si ndihmës gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë gjatë periudhës 10.11.1997 – 13.5.2000; librezë pune e ish-bashkëshortit të subjektit, sipas së cilës ka punuar gjatë periudhës 30 dhjetor 1985 – 30 prill 1990 në Komisaratin e Policisë Përmet, më pas është transferuar në Komisaratin e Policisë Sarandë për periudhën 1 maj 1990 – 31 gusht 1992¹⁵.
31. Ndonëse janë konstatuar pasaktësi në deklarimin e subjektit mbi disponibilitetin e kursimeve në vitet 2005 dhe 2006 në DIPP-të përkatëse, sikurse është sipërcituar, Komisioni ka marrë në konsideratë edhe shtesat plotësuese të kryera nga subjekti në DIPP-në e vitit 2007 dhe ka përfshirë në analizën e burimeve të ardhurat, duke filluar nga viti 2005, pa i konsideruar si të disponueshme vitet e mëpasshme kursimet e mundshme në *cash*, të cilat nuk ishin deklaruar si të mbartura në vitet pasrendëse. Në analizë financiare janë përllogaritur të ardhurat e periudhës së sipërcituar, të cilat sipas

¹³ Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si të ardhura nga qiraja e një zyre në masën 30.000 lekë.

¹⁴ Në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti nuk rezulton të jetë bashkëlidhur ndonjë dokument pas këtij vërtetimi.

¹⁵ Nga periudha 1.9.1992 – 14.1.1993 ka qenë oficer aktiv në Ministrinë e Rendit Publik. Ka rifilluar punë në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave më 23.9.1996 deri më 16.12.1996 dhe nga kjo datë ka kaluar doganier në Doganën e Gjirokastrës deri më 7.12.1997.

pretendimeve të subjektit kanë shërbyer për pagesën e këstit të parë. Nga përlllogaritjet e kryera të ardhurat kanë rezultuar në masën 1.933.834 lekë¹⁶. Komisioni ka përlllogaritur gjithashtu shpenzimet e familjes së subjektit për të njëjtën periudhë, të cilat rezultuan në masën 438.228 lekë, si dhe investimin e kryer prej tyre përgjatë kësaj periudhe në blerjen e automjetit me targa GJ ***¹⁷, në përfundim të së cilës ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për kryerjen e pagesës së këstit të parë, me burime të ligjshme financiare. Gjithashtu, Komisioni ka përlllogaritur të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të ish-bashkëshortit të saj për periudhën maj 2006 – shkurt 2007, të cilat kanë shërbyer për pagesën e këstit të dytë të pasurisë në analizë dhe nga përlllogaritjet të ardhurat për këtë periudhë kanë rezultuar në masën 694.879 lekë.

32. Nga shqyrtimi i DIPP-ve së viteve 2007 dhe 2008 ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura të ish-bashkëshortit të saj nga punësimi jashtë Shqipërisë, në shtetin grek. Lidhur me këto të ardhura, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të paraqesë dokumentacionin ligjor mbi përfitimin e të ardhurave, si dhe pagimin e detyrimeve tatimore përkatëse. Në përgjigje të pyetësorit, subjekti ka paraqitur një deklaratë nga shtetasja P. K., e cila ka pohuar se shtetasi J. K. ka punuar në kompaninë e saj gjatë periudhave korrik – dhjetor 2006 dhe qershor – nëntor 2007 dhe të ardhurat *neto* kanë qenë në masën 1.000 euro/muaj, por nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion ligjor që të provonte kryerjen e pagesës së detyrimeve tatimore përkatëse. Në këto kushte, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, e riftoi subjektin e rivlerësimit të paraqesë dokumentacionin ligjor nga institucionet/organet kompetente në shtetin grek, për të provuar pagesën e detyrimeve tatimore përkatëse për të ardhurat e përfituara. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 15.4.2021, për pagimin e kontributeve të siguracionit dhe atyre tatimore nga punëdhënësi, për të cilën Bashkia e Patrës ka vërtetuar saktësinë e nënshkrimit të punëdhënësit P. K..
33. Nga shqyrtimi i dokumentit të paraqitur, rezulton se Bashkia e Patrës ka vërtetuar vetëm nënshkrimin e punëdhënësit, ndërkohë që mungon vërtetimi konkret nga organi kompetent në shtetin grek mbi sasinë e të ardhurave të përfituara, si dhe pagimin e të gjithë detyrimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe detyrimeve tatimore për këto të ardhura, nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, referuar periudhës së punësimit në shtetin grek. Në këto kushte, Komisioni përlllogariti gjithashtu shpenzimet e familjes së subjektit për të njëjtën periudhë, të cilat rezultuan në masën 654.254 lekë¹⁸.
34. Referuar korrigjimit të kryer nga subjekti i rivlerësimit në datën 9.1.2009, kursimet e disponuara prej 750.000 lekësh në vitin 2006 janë pakësuar në vitin 2007, për kryerjen e pagesës së këstit të dytë. Pas konsiderimit edhe të kursimeve të mbetura, pas kryerjes së pagesës së këstit të parë, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e kursimeve prej 750.000 lekësh, si dhe

¹⁶ Në këtë përlllogaritje janë përfshirë të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të ish-bashkëshortit të saj, si dhe të ardhurat nga shitja e automjetit me targa SR ***, në masën 250.000 lekë. Po ashtu, janë shtuar të ardhurat nga mësimdhënia në Institutin e Formimit Profesional “Frymë dashurie”, në mënyrë përpjesëtimore, në raport me të ardhurat totale të përfituara për atë vit.

¹⁷ Në përlllogaritje është konsideruar çmimi i blerjes 312.400 lekë së bashku me tarifën e zhdoganimit të paguar prej 214.616 lekësh.

¹⁸ Nga të cilat, shuma prej 365.542 lekësh përbën shpenzimet për jetesën në Greqi të ish-bashkëshortit të subjektit, në periudhën 6-mujore të vitit 2006, të punësimit në shtetin grek, përlllogaritur kjo bazuar në të dhënat zyrtare të Eurostat-it. Linku: https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/soe.do?dataset=ilc_li01&lang=en.

kryerjen e pagesës së kështit të dytë prej 9.000 euro, në masën 747.206 lekë¹⁹, siç është detajuar në tabelën vijuese.

Tabela nr. 1 – analiza e burimeve për pagesën e kështit të dytë të blerjes së zyrës

Të ardhurat maj 2006 - shkurt 2007	694 879
Kursime të mbetura nga kështi I	120 387
Shpenzime jetese/udhëtimi	- 288 711
Shpenzime jetike në Greqi	- 365 542
Krijuar kursime <i>cash</i> në fund të vitit 2006	- 750 000
Kursime <i>cash</i> të përdorura për blerjen	750 000
Ndryshimi në likuiditete	179 972
Pagesa e kështit II për njësinë (9.000 euro)	- 1 088 190
Totali	- 747 206

35. Për kryerjen e pagesës së kështit të tretë dhe të fundit prej 3.600 euro në nëntor të vitit 2008, të deklaruar në DIPP-në e vitit 2008, Komisioni ka përllogaritur vetëm të ardhurat e këtij viti²⁰ në masën totale 1.307.824 lekë, të cilat rrjedhin nga pagat e subjektit, të ardhurat nga qiradhënia e zyrës, si dhe të ardhura nga mësimdhënia. Pas përllogaritjeve të shpenzimeve²¹ të familjes së subjektit, si dhe të investimeve/pagesave të kryera prej tyre, ka rezultuar se për kryerjen e pagesës së kështit të tretë prej 3.600 euro për përfundimin e punimeve, si dhe krijimin e kursimeve *cash* në fund të vitit 2008, subjekti ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në masën 920.276 lekë.

Tabela nr. 2 – analiza e burimeve për vitin 2008

Të ardhurat e vitit 2008	1 307 824
Kursime të mbetura	-
Shpenzime të vitit	- 989 401
Shpenzime të përfundimit të punimeve	- 50 000
Kryer pagesë për truallin në Dropull	- 53 400
Shpenzime jetese në Greqi (vajza)	- 221 729
Krijuar kursime <i>cash</i> në fund të vitit 2008	- 356 957
Ndryshimi në likuiditete	- 113 156
Pagesa e kështit III për njësinë (3.600 euro)	- 443 457
Totali	- 920 276

¹⁹ Përkatesisht -495.518 lekë për krijimin e kursimeve në shumën 750.000 lekë dhe -251.689 lekë për kryerjen e pagesës prej 9.000 euro.

²⁰ Duke qenë se në vitin 2007 subjekti ka deklaruar pakësimin e kursimeve të disponuara në vitin 2006 prej 750.000 lekësh.

²¹ Ndër të tjera, në shpenzimet e familjes janë përllogaritur edhe shpenzime jetese në Greqi të vajzës së subjektit, përgjatë ndjekjes së studimeve në Patra, Greqi. Këto shpenzime janë konsideruar të barabarta me vlerën e bursës së përfituar prej saj nga Ministria e Jashtme e Republikës së Greqisë, pasi referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, vendim nr. 9/2018 (JR), datë 24.10.2018, "*Bursa akordohet si kuotë financiare për ushqim dhe shpenzime të tjera të vogla të studentit, të cilat hyjnë si shpenzime bazë jetese pa përfshirë luksin. Një ndër arsytet për të cilat edhe studentët punojnë gjatë qenies në universitet, është për shkak të përballimit të shpenzimeve, për të cilat nuk është e mundur të përballohen vetëm me bursën e akorduar nga universiteti*". Për më tepër, edhe referuar të dhënave zyrtare të Eurostat-it, shpenzimet e jetesës në shtetin grek, përgjatë kësaj periudhe, janë pothuajse në këto nivele. https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=ilc_li01&lang=en

Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga qiradhënia e zyrës në analizë

36. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se duke filluar nga DIPP-ja e vitit 2008 e në vijim ka dhënë me qira njësinë (zyrë), kundrejt vlerës 30.000 lekë/muaj. Bashkëlidhur deklaratës *Vetting* subjekti ka dorëzuar dy kontrata qiraje, përkatësisht kontratën nr. ***, të datës 4.3.2008, të nënshkruar nga ish-bashkëshorti i subjektit në cilësinë e qiradhënësit dhe subjektit politik “LSI, dega Gjirokastër”, si dhe kontratën e qirasë nr. ***, datë 14.5.2014, të nënshkruar ndërmjet subjektit dhe shtetasit A. M., përfaqësues i “LSI, dega Gjirokastër”.
37. Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë të gjitha kontratat e qirasë të nënshkruara mes palëve përgjatë periudhës 2008 e në vijim. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka bërë me dije se: *“Kontratat e qirasë nuk janë rinovuar me shkrim në përfundim të secilës kontratë, por janë zgjatur në heshtje dhe në komunikim gojarisht midis palëve. Në fakt, që ditën e firmosjes së kontratës së parë në datën 4.3.2008 dhe deri më sot kjo zyrë ka qenë me qira nga subjekti politik ‘LSI, dega Gjirokastër’. Në rastin konkret, zyra ka qenë gjithë kohës në përdorim të subjektit LSI, gjë që deklarohet dhe nga qiramarrësi. Pra, në një periudhë të ndërmjetme kontrata ka vazhduar në heshtje, por pa ndërprerje midis të njëjtave palë”*.
38. Subjekti, së bashku me përgjigjet e mësipërme, ka paraqitur edhe një deklaratë²² të datës 18.2.2021, nga subjekti politik “LSI, dega Gjirokastër²³”, e nënshkruar nga shtetasit V. T. dhe A. L., në të cilën kanë deklaruar se me subjektin e rivlerësimit dhe ish-bashkëshortin e saj kanë lidhur kontratë qiraje për njësinë në lagjen “****”, Gjirokastër, prej vitit 2008 e në vazhdim, pa ndërprerje. Po ashtu, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ka paraqitur një kontratë qiraje me nr. ***, datë 23.5.2012, të lidhur midis ish-bashkëshortit të saj dhe shtetasit G. S., si dhe një kontratë qiraje me nr. ***, datë 1.6.2017, të lidhur me subjektin politik “LSI”, për dhënien e ambientit zyrë me qira.
39. Në përgjigje të pyetësorit standard nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se detyrimet tatimore për zyrën janë paguar sipas kontratave, përkatësisht nga palët. Në vijim të këtij deklarimi, Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë dokumentacionin ligjor që provon kryerjen e pagesës së detyrimeve tatimore përgjatë të gjithë periudhës që kjo pasur ishte dhënë me qira.
40. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka paraqitur një deklaratë të datës 21.8.2009, nga subjekti politik “LSI, dega Gjirokastër”, në të cilën ka deklaruar se për periudhën 1.3.2008 – 30.6.2009 janë paguar të gjitha pagesat për qiranë, energjinë elektrike, ujin dhe tatimin mbi qiranë e zyrës, duke bashkëlidhur edhe mandatarkëtimin e datës 20.8.2009, të “Raiffeisen Bank”, me përshkrimin “tatim qiraje mars 2008 – 30 qershor 2009” për shtetasin J. K., veprim ky i nënshkruar nga përfaqësuesi i subjektit politik “LSI”, shtetasi G. S. Gjithashtu, subjekti ka bërë me dije se sipas kontratave të qirasë dhe ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, tatimi në burim për të ardhurat nga qiradhënia paguhet

²² Me vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., datë 9.3.2021, nga noter E. P. A., Dega Vendore Gjirokastër.

²³ Lidhur me ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesave me shtetasit A. M. dhe G. S., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2020, ka bërë me dije se janë 3 vendime të dhëna nga kjo gjykatë, nga të cilat 2 për shtetasin A. M. dhe 1 për shtetasin G. S., por rezultojnë se këto vendime nuk janë shqyrtuar/gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, për rrjedhojë, nuk ka rezultuar ndonjë konflikt i interesit me këta shtetas. Gjithashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2021, ka bërë me dije se nga verifikimi i regjistrave civilë dhe penalë të kësaj gjykate, si dhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tepelenë për periudhën 2008 – 2019, për shtetasit dhe subjektet e përmendur në shkresën nr. *** prot., datë 5.5.2021, nuk ka rezultuar të ketë vendime gjyqësore.

nga qiramarrësi, duke shtuar se për vitet 2015 dhe 2016²⁴ tatimi është paguar nga ajo vetë, për shkak se nga subjekti politik “LSI” nuk iu vunë në dispozicion dokumentacioni lidhur me pagesat përkatëse.

41. Lidhur me pagesat tatimore për vitet e tjera, subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 18.2.2020, të lëshuar nga DRT-ja Tiranë, e cila ka bërë me dije se subjektit politik “LSI” ka paguar në total për zërin “tatim në burim (qira)” vlerën prej 13.458.893 lekësh, për periudhën dhjetor 2014 e në vijim, por nuk mund të individualizohet emri i subjektit, pasi nga ana e tatimpaguesit nuk ka dokumentacion të dorëzuar ku të jetë deklaruar për kë individ janë kryer pagesat.
42. Nga sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit, ka shpjeguar se: *“Duke u interesuar pranë DPT-së më sqaruan se para periudhës dhjetor 2014 nuk ekzistonte deklaratë elektronike për tatimin në burim dhe për pasojë nuk mund të më jepet informacion. Për periudhën para dhjetorit të vitit 2014 pagesat bëheshin vetëm me një përshkrim nga tatimpaguesi pranë bankës. Gjithashtu, më sqaruan se pagesat e kryera nga ana e LSI-së për periudhën dhjetor 2014 (kryer më 26.9.2015) dhe për periudhën shtator 2015 (kryer më 6.10.2015), janë shuma të mëdha (1.536.565 lekë dhe 1.481.049 lekë) dhe janë pagesa për detyrime të prapambetura nga periudhat e mëparshme. Dua të sqaroj se shuma e tatimit në burim për periudhën 2008 – 2016, që duhej të derdhej nga subjekti ‘LSI’ rezulton të jetë derdhur, pasi shuma totale e tatimit është 397.059 lekë”.*
43. Në përfundim të sa më sipër, Komisioni ka konsideruar si të ardhura me burim të ligjshëm nga qiradhënia ato të periudhës mars 2008 – qershor 2009 dhe të viteve 2015 e 2016, për të cilat është provuar pagesa e detyrimeve tatimore përkatëse. Për periudhat e tjera midis – prej të cilave disa nuk kanë rezultuar të mbuluara me një kontratë qiraje, por dhe ato të mbuluara me një të tillë, ku është specifikuar në kontratë se detyrimin për pagimin e tatimit në burim e ka qiramarrësi – për sa kohë në llogarinë e subjektit të rivlerësimit apo ish-bashkëshortit janë transferuar shumat *bruto* të qirasë prej 30.000 lekësh/muaj (ndryshe nga çka ndodhur nga qershori i vitit 2017 e në vijim, ku në llogarinë e subjektit është transferuar shuma *neto* e qirasë, pas mbajtjes së tatimit në burim) dhe nuk është mbajtur në burim tatimi mbi këto të ardhura - Komisioni nuk i ka konsideruar në analizën financiare si të ardhura me burim të ligjshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
44. Nga sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës lidhur me rezultatet si vijon:
 - Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2006 veprimin juridik të nënshkrimit të kontratës së porosisë dhe shpenzimin për kryerjen e pagesës së kështit të parë në maj të këtij viti.
 - Duket se ka mospërputhje lidhur me vlerën prej 18.000 euro të deklaruar nga subjekti si të paguar plotësisht në DIPP-të e viteve 2007 dhe 2008 dhe shumës prej 1.799.600 lekësh të përshkruar në kontratën e shitblerjes dhe në deklaratën *Vetting*.
 - Duket se ka fiktivitet në kontratën përfundimtare të vitit 2009, në bashkëpunim me shoqërinë shitëse, për sa kohë më herët ishte deklaruar e paguar e gjithë shuma dhe

²⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting*, deklaratat DIVA të viteve 2015 dhe 2016, të dorëzuara në datën 24.1.2017, në të cilat janë deklaruar të ardhurat nga qiradhënia për këto dy vite si dhe mandatet e pagesave të kryera për tatimin e qirasë për këto dy vite nëpërmjet “Societe Generale Bank Albania” (sot OTP Bank), të kryera po në datën 24.1.2017.

nga ana tjetër ulja e çmimit nuk justifikohet as në këndvështrimin sasiar, duke pasur në vëmendje shumat e shpenzimeve të pretenduara si të kryera më pas.

- Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime apo gjendje *cash* të viteve 2005 dhe 2006, të cilat më pas, sipas pretendimeve të tij, janë përdorur si burim financiar për pagesën e kështit të parë (5.400 euro) dhe të dytë (9.000 euro).
- Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e pagesave për blerjen e njësisë në analizë, si dhe realizimin e kursimeve të pretenduara në vitet 2006 dhe 2008, në total prej 1.667.482 lekësh (nga të cilat 747.206 lekë për pagesën e kështit të dytë dhe 920.276 lekë për pagesën e kështit të tretë).

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

45. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar rezultatin e arritur nga Komisioni, duke sqaruar lidhur me konstatimin e parë se nuk është lidhur një kontratë porosie në vitin 2006, por vetëm aktmarrëveshja e vitit 2007, dhe se mosdeklarimi i pagesës prej 5.400 euro, e paguar paraprakisht, është pasaktësi e korrigjuar në vitin pasardhës në DIPP-në e vitit 2007, pra nuk jemi në kushtet e mosdeklarimit, por kemi të bëjmë më një pasaktësi e korrigjuar në DPV-në e vitit 2007. Lidhur me sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka sjellë në vëmendje edhe vendimin nr. 20, datë 31.7.2019, të KPA-së²⁵, në të cilin arsyetohet se: *“...mosdeklarimi prej subjektit të rivlerësimit i blerjes së automjetit në vitin 2005 është një pasaktësi e bërë në deklarin periodik të atij viti, i cili është ndrequr në vitin 2009, me vullnetin dhe iniciativën e vetë subjektit të rivlerësimit. Në këtë kuptim, kjo pasaktësi që i përket vitit 2005, e konsideruar si e tillë, nuk mund të shërbejë si një shkak i vetëm për të analizuar më tej drejt përgjegjësisë së subjektit të rivlerësimit në raport me procesin e rivlerësimit... Kolegji çmoi se kjo rrethanë fakti, e provuar nëpërmjet deklarimeve si më sipër, duhet t’i nënshtrohej analizës financiare, duke qenë se nga hetimi nuk ka rezultuar asnjë e dhënë tjetër që të mund të vinte në dyshim ekzistencën e saj”. Gjithashtu ka sjellë në vëmendje edhe vendimin nr. 22/2019, të KPA-së, në të cilin arsyetohet se: “Trupi gjykues, megjithëse e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se deklarinet periodike të subjektit kanë pasaktësi, vlerëson se bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, pasaktësitë në deklarinet periodike të pasurisë nuk përbëjnë shkak të veçuar për të ngarkuar subjektin më përgjegjësi disiplinore”.*
46. Lidhur me mospërputhjen midis çmimit të kontratës së shitjes dhe aktmarrëveshjes së vitit 2007, vjen si rezultat i moszbatimit të të gjitha parashikimeve kontraktuale, pasi shoqëria e ndërtimit nuk i përfundoi punimet në afat dhe për këtë pranoi uljen e çmimit final, si një penalizim për mospërputhjen e detyrimeve kontraktore, duke shmangur dërgimin e çështjes në gjykatë.
47. Së treti, lidhur me analizën financiare të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të merren në konsideratë argumentet dhe faktet si vijon: (i) nga deklarimi dhe saktësimi i datës 9.1.2009, është sqaruar “gjendja *cash* e vitit 2006 e pakësuar në 2007”, pra nuk kemi të bëjmë me të gjithë shumën e kursimeve të disponuara, por me saktësimin e shumës së pakësuar gjatë vitit 2007, në të cilin i referohet edhe saktësimi, pra në vitin 2007 është pakësuar gjendja që ekzistonte në fund të vitit 2006, gjendje e cila nuk është krijuar vetëm në vitin 2006. Nga analiza financiare për vitet 2003, 2004 dhe 2005

²⁵ Vendim nr. 20/2019 (JR), datë 31.7.2019, subjekti i rivlerësimit G. O., si dhe vendimi nr. 22/2019 (JR), datë 16.9.2019, subjekti i rivlerësimit B. H..

konstatohet tepriçë e mjeteve monetare me rezultat pozitiv, përkatësisht në vitin 2003, shuma 559.347 lekë, në vitin 2004 shuma 938.429 lekë dhe në vitin 2005 shuma 456.611 lekë, në total për këto vite shuma totale është 1.954.387 lekë, shumë kjo e cila është e mjaftueshme për të mbuluar shumat negative të rezultuara nga analiza e përveçme për blerjen e zyrës dhe sigurimin me burime të ligjshme *cash* prej 750.000 lekësh.

48. Lidhur me shpenzimet e jetesës së ish-bashkëshortit në shtetin grek në shumën 365.542 lekë, këto shpenzime, bazuar në aktet e administruara gjatë hetimit, rezultojnë se ky i fundit punonte në Greqi, kundrejt pagës prej 1.000 euro/muaj, shumë e cila nuk është marrë në konsideratë në analizën financiare – e për rrjedhojë duhet të llogariten shpenzimet e jetesës për ish-bashkëshortin vetëm për periudhën janar – maj 2009. Pra, meqenëse nuk i janë njohur të ardhurat e ish-bashkëshortit, ka kërkuar edhe mos marrjen në konsideratë edhe shpenzimet për të në shtetin grek. Gjithashtu, ka saktësuar edhe shpenzimet e udhëtimit nga 599.956 lekë në 237.923 lekë, duke konsideruar udhëtimet brenda ditës me destinacion Janinën, një kosto prej 20 euro, në vend të 25 euro, si dhe qëndrimet për shtetasit M. K. dhe J. K..
49. Gjithashtu, subjekti ka kërkuar edhe njohjen e bursës së përfituar nga vajza si e ardhur për të mbuluar kostot e llogaritura për të në shtetin grek, duke vënë në dispozicion edhe një raport të audituesit financiar, i cili ka kryer: (i) përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit për vitin 2008, nga të cilat ka rezultuar se vlera e shpenzuar për këtë vit për udhëtime ka qenë rreth 223.264 lekë; (ii) përlllogaritjen e të ardhurave të përfituara nga qiraja të cilat janë arkëtuar në “Raiffeisen Bank” në llogarinë e ish-bashkëshortit, ku shuma e qirasë për vitin 2008, e marrë në konsideratë nga Komisioni, është 300.000 lekë. Referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006, të Ministrisë së Financave, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, përcakton se: *“Dividendët, të ardhurat që rrjedhin si fitim i ortakut, qoftë ky ortak i vetëm, tathohen me 8%... në pikën 2.6.3, përcaktohet se: ‘Për pagesa të tjera që lidhen me të ardhurat e listuara në gërmat ‘b’ deri në ‘g’ të nenit 8, pagesi i të ardhurave mban në burim tatimin, sipas tarifave të përmendura në pikën 2.5.2 më lart, dhe derdh atë në organin tatimore përkatës jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës”*. Në vijim nga subjekti i rivlerësimit është cituar vendimi nr. 212/2019, i Komisionit²⁶, i cili duhet të mbahet në konsideratë në vlerësimet që do të kryhen.

Vlerësimi i trupit gjykues

50. Nisur nga analiza e rrethanave faktike, ligjore e jurisprudenciale të sipërcituara, Komisioni çmon që fillimisht të vërë në pah faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar veprimin juridik të nënshkrimit të kontratës së porosisë me shoqërinë “F.” sh.p.k. në vitin 2006, veprim që bie në kundërshtim me detyrimin e subjektit për deklarim sipas ligjit, ndonëse e ka saktësuar/plotësuar këtë mangësi në vitin 2009.
51. Lidhur me mospërputhjen e çmimit prej 18.000 euro të deklaruar nga subjekti si të paguar totalisht paraprakisht dhe shumës prej 1.799.600 lekësh të përshkruar si çmim në kontratën e shitjes në vitin 2009, trupi gjykues, duke vlerësuar dinamikën dhe kontradiktat e rezultuara midis deklarimeve dhe pagesave të kësteve përkatës (si më sipër përshkruar), si dhe në mungesë të një logjike ekonomike për shoqërinë ndërtuese që të

²⁶ Vendimi nr. 212/2019, për subjektin e rivlerësimit K. Z.; vendimi nr. 161, datë 18.6.2019; vendimi nr. 162, datë 19.6.2019; vendimi nr. 241, datë 26.2.2020; dhe vendimi nr. 274, datë 20.7.2020.

pakësonte me çmimin e dakordësuar prej 400.043 lekësh, për shkak të moskryerjes së disa punimeve, të cilat kanë rezultuar me vlerë vetëm 50.000 lekë, vlerësohet se kontrata e shitblerjes në vitin 2009 përmban një çmim fiktiv, duke përshkruar, në bashkëpunim me shoqërinë ndërtuese/shitëse, një vlerë më të ulët se vlera reale e shitblerjes së pasurisë në fjalë. Kjo për shkak se ulja e çmimit të blerjes së pasurisë në kontratën e shitblerjes në fjalë, përveç që bie ndesh me faktin që ishte totalisht e paguar e gjithë shuma prej 18.000 euro më herët, nuk justifikohet as në këndvështrimin sasior të lidhjes shkak-pasojë, duke marrë në konsideratë dhe duke iu referuar vlerës minimale prej 50.000 lekësh të shpenzimeve të kryera nga subjekti pas blerjes për përfundimin e punimeve, në raport diferencën prej 400.043 lekësh që rezulton midis çmimit të porositur dhe çmimit të blerjes së pasurisë. Pra, nëse çmimi i kontratës së vitit 2009 do të rezultonte i besueshëm, subjekti do të kishte përfituar një trajtim preferencial, të cilin nuk e ka deklaruar, pasi rezulton një ulje çmimi prej së paku 350.043 lekë e pajustificuar që shkon kundër interesave të palës shitëse dhe që nuk gjen asnjë logjikë ekonomiko-financiare në optikën e një shoqërie që ka për qëllim realizimin e fitimeve në treg.

52. Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga qiradhënia e njësisë zyrë, për të cilat subjekti i rivlerësimi ka paguar detyrimet tatimore për vitin 2010, pas marrjes së rezultateve të hetimit, trupi gjykues, duke iu referuar edhe jurisprudencës dhe orientimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit²⁷ - sipas të cilave pagesa e detyrimeve tatimore pas dorëzimit të deklaratës *Vetting* nuk mund të zhbëjë qasjen e subjekteve në kundërshtim me ligjin ndër vite, të karakterizuar pikërisht nga mospagimi i detyrimeve tatimore në momentin dhe vitin përkatës – çmon se këto të ardhura nuk mund të konsiderohen dhe të përlllogariten si të ligjshme, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë për këto të ardhura nuk janë paguar tatimet kur ato janë realizuar por përgjatë procesit të rivlerësimit, ndërkohë që detyrimet tatimore përkatëse duhet të ishin shlyer sipas parashikimeve të dispozitave ligjore përkatëse, shumë vite me herët.
53. Lidhur me pretendimin e subjektit për uljen e shpenzimeve të jetesës sipas rajonit, pasi në Gjirokastër jetesa ka më pak kosto, Komisioni vlerëson se shpenzimet e konsideruara në analizën financiare janë vlera statistikore mesatare për të gjithë vendin si të tilla – duke qenë se janë vlera minimale jetike dhe kompensojnë në favor të subjekteve edhe diferencat e mundshme – ato mbeten në çdo rast më poshtë se niveli i kostove jetike reale dhe nuk lenë hapësira të uljes së tyre poshtë minimumit, në funksion të vendndodhjes së qytetit/fshatit ku ka jetuar familja e subjektit, me përjashtim të rasteve që mund të provohet e kundërta.
54. Lidhur me kërkesën mbi përfshirjen e të ardhurave/kursimeve të viteve 2003 dhe 2004 në kursimet e vitit 2006, Komisioni ka marrë në konsideratë në përlllogaritjet e kryera deklaratimet e subjektit në DIPP-të ndër vite dhe korrigjimet e kryera në vitet pasardhëse, në të cilat nuk kanë qenë përfshirë/deklaruar kursime të viteve 2003 dhe 2004 dhe, për rrjedhojë, sipas jurisprudencës së konsoliduar tashmë, për sa kohë në vitet përkatëse nuk janë deklaruar kursime *cash*, pretendimet e mëpasshme në këtë drejtim nuk mund të pranohen, edhe nëse përgjatë atyre viteve mund të kishte pasur teorikisht, sipas përlllogaritjeve të analizës financiare, mundësi kursimi, të pa kanalizuar në gjendjen e llogarive bankare.

²⁷ Vendimi nr. 5/2020 (JR), datë 13.3.2020, përfshirë mendimin paralel dhe mendimin e pakicës, subjekti i rivlerësimit A. K..

55. Lidhur me të ardhurat nga bursa e vajzës së subjektit nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion shtesë provues mbi bursën e përfutur në vitet 2008, 2010 dhe 2011, për rrjedhojë, duket se ato mbeten në nivel deklarativ, duke marrë në konsideratë çka ka rezultuar e provuar me dokumentacion ligjor.
56. Lidhur me shpenzimet e udhëtimeve të ish-bashkëshortit të subjektit për shkaqe pune, të pretenduara si të përlllogaritura jo në mënyrë të saktë, nga dokumentacioni i disponuar nga Komisioni ka rezultuar se hyrje-daljet për në Korfuz në fakt janë kryer nga babai i subjektit J. I. dhe jo nga ish-bashkëshorti J. K., për rrjedhojë, ky pretendim për të dy udhëtimet e përmendura gjendet i pabazuar. Sa i përket daljes së vajzës së subjektit në datën 17.8.2008, duket se kjo është jashtë periudhës së kontestuar 13.7 – 27.7, për rrjedhojë, kjo dalje në një periudhë të mëvonshme nuk ndikon në përlllogaritjen e kryer nga Komisioni. Lidhur me udhëtimin e vajzës së subjektit në periudhën 30.7 – 10.8, për të cilin është pretenduar se datat nuk janë nga raporti i sistemit *TIMS*, nga rikontrolli i kryer nga Komisioni ka rezultuar se ky udhëtim si në sistemin *TIMS*, ashtu edhe në raportin e kryer, është në fakt udhëtim i kryer nga ish-bashkëshorti i subjektit, për rrjedhojë, pretendimi gjendet i pabazuar.
57. Në përfundim të sa më sipër lidhur me shpenzimet e udhëtimit të familjes së subjektit, Komisioni ka pranuar: (i) pretendimet mbi shpenzimet ditore prej 20 euro/dita në Janinë në vend të 25 euro të përlllogaritura më herët nga Komisioni; (ii) prerjen e kartonit jeshil 1 herë në vit me vlerën 400 euro/vit; si dhe (iii) ka rikonsideruar udhëtimet me autobus, të cilat ulin shpenzimet e përlllogaritura mbi udhëtimet nga 599.956 lekë, në 573.599 lekë.
58. Lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të ish-bashkëshortit të subjektit, trupi gjykues vlerëson se nga hetimi administrativ nuk rezultoi e provuar me dokumentacion ligjor ligjshmëria e krijimit të të ardhurave të pretenduara në vitet 2008 dhe 2011 dhe as kryerja e pagesës së detyrimeve tatimore nga punësimi i tij në shtetin grek, të cilat do të shërbenin si burim i ligjshëm për blerjen e pasurisë “zyrë”. Nga sa është administruar, shqyrtuar dhe vlerësuar nga Komisioni, mbi këtë pikë nuk ka rezultuar e provuar me dokumente ligjore marrëdhënia e punësimit, fitimet e realizuara, si dhe tatimet e kontributet e paguara në raport me këto të ardhura, pasi pretendimet në fjalë mbeten në nivel deklarativ, qofshin ato të bazuara edhe mbi deklarime të personave të tretë, të bëra përpara autoriteteve të huaja, të cilat nuk mund të veshin/atribuonjë këtyre të ardhurave ligjshmërinë faktike e tatimore, për sa kohë nuk mbështeten në dokumente të lëshuara nga autoritetet kompetente tatimore dhe sigurime shoqërore. Kësisoj, pretendimet e subjektit në këtë pikë mbeten të paprovuara lidhur me ligjshmërinë dhe në vijueshmërinë e këtyre të ardhurave, për sa kohë mungojnë provat e mirëfillta si në aspektin sasior, ashtu edhe në atë cilësor, duke mos plotësuar kriteret e parashikuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, për t’i kualifikuar si burime të ligjshme.
59. Lidhur me të njëjtën periudhë, 2008 – 2011, subjekti ka pretenduar gjithashtu se së paku Komisioni mund të evitojë të konsiderojë shpenzimet jetike të ish-bashkëshortit në raport me të ardhurat e realizuara vetëm nga subjekti, për sa kohë nuk merren në konsideratë të ardhurat e tij të realizuara në Greqi. Mbi këtë pretendim, duke pasur në vëmendje se së paku prezenca e ish-bashkëshortit të subjektit në Greqi në periudhën 2008 – 2011 mund të konsiderohet e provuar, gjithashtu pasja e marrëdhënieve shoqërore atje, por edhe punësimi i tij mund të konsiderohen pjesërisht të konfirmuara nga disa dokumente, edhe pse nuk provohen të ardhurat me burim të ligjshëm, nuk mund të përjashtohet mundësia që, duke pasur marrëdhënie punësimi, edhe pse pa paguar tatimet, shtetasi J. K. të krijonte

së paku të ardhurat apo mjetet alternative për mbijetesë në shtetin grek, pa i rënduar familjes së tij në Shqipëri me shpenzimet jetike. Në këto rrethana, trupi gjykues, duke e çmuar situatën konkrete nën dritën e parimit të proporcionalitetit, vlerëson se analiza financiare e subjektit nuk duhet të rëndohet me shpenzimet jetike të shtetasit J. K. përgjatë kohës që ky i fundit ka jetuar në Greqi, për sa kohë ekziston dyshimi i arsyeshëm se ky i fundit nuk ka përfituar mjete monetare nga familja e tij për të jetuar kaq gjatë në Greqi, pa të ardhurat e veta.

60. Për rrjedhojë të sa më sipër, në këto kushte dhe nisur nga arsyetimet e sipërargumentuara dhe duke ripërlllogaritur analizën e mundësive financiare të familjes së subjektit të rivlerësimit, pasi janë pranuar pjesërisht pretendimet e subjektit lidhur me shpenzimet e ish-bashkëshortit përgjatë periudhës që ka jetuar në Greqi, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur një pamjaftueshmëri financiare për blerjen e pasurisë në fjalë në shumën 1.268.217 lekë (nga të cilat 374.298 lekë për këstin e parë dhe 893.919 lekë për këstin e dytë).

2. Shesh ndërtimi me sipërfaqe 400 m², ndodhur në Sarandë

61. Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri të përfituar me anë të deklaratës noteriale²⁸, e cila nuk rezulton të jetë e regjistruar dhe as e konfirmuar nga ASHK-ja Sarandë.
62. Nga shqyrtimi i DIPP-ve përkatëse, duke filluar nga DIPP-ja e vitit 2003 e në vijim deri në vitin 2014, nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar ekzistencën e pasurisë të llojit “shesh ndërtimi” me sip. 400 m², në bllokun *** shtesë, parcela ***,. Ndërkohë, në deklaratën *Vetting* ka deklaruar pasurinë të mbetur në pronësi të saj pas zgjidhjes së martesës.
63. Nga sa më sipër është evidentuar, Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 2, për të dhënë shpjegime lidhur me mosdeklarimin e kësaj pasurie në vitin 2003, si dhe nëse prej saj është bërë ndonjë investim/ndërtim mbi këtë truall. Në përgjigje të saj subjekti ka shpjeguar se: *“Mosdeklarimi në vitin 2003 ka të bëjë thjesht me faktin se nuk e kisha kuptuar drejtë mënyrën e plotësimit të deklaratës, prandaj e kam shtuar në deklaratën e vitit 2004. Kam menduar se duheshin deklaruar vetëm të ardhurat e vitit 2003”*. Gjithashtu ka shtuar se në këtë pasuri nuk është kryer asnjë investim as prej saj dhe as nga ish-bashkëshorti, duke shoqëruar përgjigjen me një foto, në të cilën nuk duket ndonjë ndërtim.
64. Komisionit, nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2004, i ka rezultuar se subjekti ka deklaruar vetëm një truall me sip. 400 m², të përfituar nga ish-bashkëshorti, ndërkohë që nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se ata kanë përfituar me të njëjtin vendim të Këshillit Bashkiak Sarandë nga një sipërfaqe trualli secili, përkatësisht 400 m² dhe 367,8 m², pasuri të cilat, pas zgjidhjes së martesës dhe nënshkrimit të deklaratës noteriale të vitit 2014, subjekti ka marrë tokën e përfituar prej saj me sipërfaqe 400 m² dhe ish-bashkëshorti tokën e përfituar prej tij me sipërfaqe 367,8 m².
65. Për të provuar sa më sipër, së bashku me përgjigjet e pyetësorit, subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 4.3.2021, nga Bashkia Sarandë²⁹, e cila ka bërë me dije se

²⁸Marrëveshje për ndarjen e pasurisë bashkëshortore, me nr. ***, datë 6.2.2014.

²⁹ Komisioni iu drejtua Bashkisë Sarandë me shkresën nr. *** prot., datë 16.4.2021, për informacione lidhur me këtë pasuri, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 16.4.2021, ka kërkuar saktësimin e të dhënave (numër dhe parcelë) për pasurinë “shesh ndërtimi” me sipërfaqe 400 m², të miratuar me vendimin nr. ***, datë 28.8.1999, të Këshillit Bashkiak.

subjekti i rivlerësimit është trajtuar me shesh ndërtimi, në bazë të vendimit nr. ***, datë 28.8.1999, të Këshillit Bashkiak, për të cilën nuk është realizuar lidhja e kontratës së shitblerjes së truallit, si dhe në bazë të vendimit nr. ***, datë 9.4.2000, të KRRT-së, Bashkia Sarandë, është miratuar planimetria e sheshit të ndërtimit për të cilin ka dalë leja e ndërtimit, e cila rezulton aktualisht e paekzekutuar në terren.

66. Për këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin ligjor, si vijon:

- i. vendim nr. ***, datë 28.8.1999, të Këshillit Bashkiak Sarandë, sipas studimit urbanistik nr. ***, datë 19.2.1999, të miratuar nga KRRT-ja Sarandë me, sipas së cilës subjektit të rivlerësimit Mirela Kore i është dhënë si investitore e sheshit të ndërtimit, blloku ***, parcela ***, me sip. 400 m²; procesverbal i datës 18.1.2002, mbi piketimin e parcelës *** shtesë, nr. ***, nga Zyra e Urbanistikës së Bashkisë Sarandë, për piketimin e sheshit të ndërtimit sipas KRRT-së të Bashkisë Sarandë dhe vendimit nr. ***, datë 11.8.2000, të Këshillit Bashkiak;
- ii. mandatpagesë e datës 15.3.2002, për pagesën e truallit në masën 192.384 lekë, paguar nga subjekti i rivlerësimit Mirela Kore, në favor të Bashkisë Sarandë;
- iii. planimetri e sheshit të ndërtimit të objektit “banesa nr. ***”, në shtesë të kurorës së qytetit, të miratuar me vendimin nr. ***, datë 9.4.2000, të KRRT-së, me sipërfaqe të përgjithshme 400 m², sipërfaqe ndërtimi 200 m² dhe 2-3 kate;
- iv. ASHK-ja Sarandë, me shkresën nr. *** prot., datë 25.1.2021, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, ka bërë me dije se nuk ka rezultuar ndonjë pasuri e paluajtshme e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit Mirela Kore, si dhe nga verifikimi i sistemit elektronik të vetëdeklarimeve për legalizim nuk ka rezultuar ndonjë aplikim për legalizimin e ndonjë pasurie informale. ASHK-ja është shprehur se për pasurinë në fjalë shesh ndërtimi, me sip. 400 m², parcela nr. ***, miratuar me vendimin nr. ***, datë 28.8.1999, të Këshillit Bashkiak Sarandë, nuk mund të japë informacion me këto të dhëna pasurie.

Lidhur me analizimin e burimeve për blerjen e pasurisë

67. Ashtu sikurse është sipërpërshkruar, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për kryerjen e pagesës së pasurisë “shesh ndërtimi me sip. 400 m²” në analizë, por ka deklaruar vetëm përfitimin e kësaj pasurie me vendimin e Këshillit Bashkiak Sarandë. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se pagesa prej 192.384 lekësh për truallin shesh ndërtimi në favor të Bashkisë Sarandë është kryer nga subjekti i rivlerësimit në datën 15.3.2002.
68. Komisioni ka përlllogaritur të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortit për periudhën 2001 – shkurt 2002, të cilat kanë rezultuar në masën 852.771 lekë. Pas përlllogaritjes së shpenzimeve jetike për të njëjtën periudhë ka rezultuar se subjekti ka pasur mjaftueshmëri të burime të ligjshme financiare për kryerjen e pagesës në fjalë.
69. Nisur nga sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, ka rezultuar se:
 - Duket se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar njërin prej shesheve të ndërtimit të përfituar prej saj me vendimin nr. ***, datë 28.8.1999, të Këshillit Bashkiak, nga DIPP-ja e vitit 2003 e në vijim deri në vitin 2014.
 - Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e pagesës së truallit në vitin 2002.

- Duket se kjo pasuri është përfituar në mënyrë të dyshimtë, referuar kriterëve përcaktuese dhe vijueshmërisë së gjendjes faktike, për sa kohë familja e saj ka përfituar njëkohësisht tre sheshe ndërtimi (nga të cilët dy me të njëjtin vendim të Këshillit Bashkiak). Për rrjedhojë, duket se nëpërmjet përfitimeve të mësipërme, subjekti ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

70. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar rezultatin e arritur nga Komisioni, duke pretenduar se pasuria në fjalë nuk ka kaluar asnjëherë në pronësi të saj. Për këtë pasuri është miratuar leja e ndërtimit, por nuk është kryer kalimi i pronësisë nga shitësi Këshilli Bashkiak Sarandë, edhe pse është kryer pagesa e vlerës së çmimit të truallit dhe se nuk është nënshkruar asnjë herë kontratë para noterit, ashtu sikurse parashikojnë dispozitat e Kodit Civil për shitblerjen e pasurive të paluajtshme. Referuar nenit 29 të ligjit nr. 7693, datë 6.4.1993, “Për urbanistikën”, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se kanë kaluar afatet e parashikuara në ligj për ndërtimin për sheshe ndërtimi dhe se shkelja e këtyre afateve e bën të pavlefshëm vendimin e miratimit të sheshit të ndërtimit në fjalë.
71. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nga familja e ish-bashkëshortit në vitin 1993 ishte bërë kërkesë dhe se ai ka përfituar një shesh ndërtimi që në vitin 1995, fillimisht me vendim të Këshillit Bashkiak, i cili është anuluar në tërësinë e tij me vendim gjykate për zonën Sarandë-Kanal i Cukës. Më pas, kjo zonë është trajtuar përsëri me VKM-në nr. ***, datë 25.8.1999, ku u bë edhe rishpërndarja e shesheve tek qytetarët, kështu, familja e ish-bashkëshortit ka bërë kërkesë për plotësimin e nevojave të familjes.

Vlerësimi i trupit gjykues

72. Komisioni, pasi vlerësoi shpjegimet në seancën dëgjimore nga subjekti i rivlerësimit në datën 9.7.2021, lidhur me përfitimin e shesheve të ndërtimit nga subjekti dhe familja e ish-bashkëshortit, çmon se ato nuk janë bindëse dhe shteruese. Në vlerësim tërësor të fakteve, gërshetuar kjo me dinamikën e ngjarjeve të cituara nga subjekti i rivlerësimit – por të paqartësuara mbi mënyrën e përfitimit të pasurive truall disa vite më vonë nga subjekti dhe familja e saj – arrihet në konkluzionin se familja e subjektit të rivlerësimit ka përfituar në mënyrë të dyshimtë njëkohësisht tre shesheve të ndërtimit pa plotësuar kriteret përkatëse dhe pa ndërmarrë prej saj ndonjë veprim distancimi, duke pranuar përfitimin e padrejtë, madje pa e deklaruar përfitim e njërit prej shesheve as në deklaratat vjetore dhe as në atë *Vetting* – siç do të arsyetohet në mënyrë të përmbledhur mbi të tre trojet e përfituara në raport me pozicionin dhe përfshirjen e subjektit të rivlerësimit, në vijim pasurisë nr. 3.

3. Shesh ndërtimi me sipërfaqe 456 m², ndodhur në komunën D. i P., Gjirokastrë

73. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2004 në emër të ish-bashkëshortit, si pasuri e llojit “truall”, me sip. 600 m², e ndodhur në komunën D. i P., e përfituar me vendimin nr. ***, datë 28.2.2003, të Këshillit të Komunës “Për miratimin e shesheve të ndërtimit”. Sipas deklaratës noteriale për ndarjen e pasurisë bashkëshortore, datë 6.2.2014, palët kanë rënë dakord që pasuria në fjalë do t’i kalonte subjektit të rivlerësimit, e cila është deklaruar prej saj edhe në DIPP-në e vitit 2014.
74. Ndërkohë, nga shqyrtimi i deklaratës *Vetting* ka rezultuar se subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri, të ndodhur në komunën D. i P., të përfituar me vendimin nr. ***, datë 28.2.2003, të Këshillit të Komunës.

75. Lidhur me mosdeklarimin e kësaj pasurie në DIPP-në e vitit 2003 dhe në deklaratën *Vetting*, nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se: *“Mosdeklarimi në vitin 2003 ka të bëjë thjesht me faktin se nuk e kisha kuptuar drejt mënyrën e plotësimit të deklaratës, prandaj e kam shtuar në deklaratën e vitit 2004. Ju bëj me dije se pavarësisht se në deklaratën për ndarjen e pasurisë është shënuar një shesh në komunën D. i P., unë realisht nuk kam asnjë lloj pasurie në këtë komunë. Në nënshkrimin e deklaratës për shkak të rrethanave të zgjidhjes së martesës nuk kam qenë e kujdesshme për detajet dhe e kam nënshkruar pa i dhënë rëndësi. Deklaroj përsëri se pasuritë reale për ndarje ishin 1 zyrë të cilën e kam deklaruar dhe 1 pasuri kullotë e ndodhur në K., të cilën e ka përfituar ish-bashkëshorti. Për më tepër unë nuk kam aplikuar kurrë për këtë truall në asnjë organ publik”*.
76. Në vijim të veprimeve hetimore, Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 23.11.2020, i ka kërkuar Bashkisë D. të vendosë në dispozicion dokumentacionin e plotë ligjor që disponohet në arkivën e Bashkisë D., për pasurinë shesh ndërtimi, më sip. 456 m², sipas vendimit nr. ***, datë 28.3.2003, të Këshillit të Komunës D.. Bashkia D.³⁰, me shkresën nr. *** prot., datë 22.1.2021, ka vënë në dispozicion dosjen e pasurisë me sip. 456 m², të dhënë me vendimin nr. ***, datë 28.3.2003, të Këshillit Bashkiak D.³¹. Nga dokumentacioni i përcjellë nga Bashkia D.³² ka rezultuar se për blerjen e truallit është paguar nga ish-bashkëshorti, nëpërmjet Bankës së Kursimeve në datën 21.7.2003, shuma prej 68.136 lekësh, ndërkohë që në deklarimin e subjektit në DIPP-në e vitit 2004 është shënuar si vlerë e blerjes së kësaj pasurie 200.000 lekë.
77. Ka rezultuar se më pas, me vendimin nr. ***, datë 5.7.2007, të KRRT-së ish-bashkëshortit të subjektit i është miratuar “leja për ndërtimin e objektit shesh depozitimi për materiale” dhe në dhjetor të vitit 2008 është përgatitur projekt-zbatimi i objektit “magazinë”, si dhe është paguar shuma prej 26.700 lekësh, e barabartë me 1% të vlerës së investimit prej 2.670.000 lekësh në favor të komunës D. i P..
78. Lidhur me këtë, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të shpjegojë arsyet e mospërputhjeve të konstatuara midis sipërfaqes së pasurisë dhe shumës së paguar për blerjen e truallit në vitin 2003, krahasuar me vlerat e deklaruara prej saj në DIPP-në e vitit 2004, si dhe të bëjë me dije lidhur me shpenzime të mundshme të ndërtimit të objektit “magazinë” mbi truallin në fjalë.

³⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 7.12.2020, dërguar Drejtorisë së Shërbimit Urban dhe Shërbimeve Publike në Bashkinë D. nga sektori i Burimeve Njerëzore, TIK dhe arkiv-protokoll i Bashkisë D..

³¹ Në këtë vendim rezulton se edhe shtetasi J. I. i është miratuar shesh ndërtimi për banesë me sip. 300 m², me vendimin nr. ***, datë 19.12.2002, të KRRT-së Gjirokastrë.

³² Bashkia D. ka vendosur në dispozicion dokumentacionin, si vijon: kërkesë e shtetasit J. K., e datës 6.1.2003, drejtuar Komunës D. i P., për pajisjen me shesh për tregtimin e materialeve të ndërtimit; vendim nr. ***, datë 28.2.2003, “Për miratimin e shesheve të ndërtimit”, në pikën 4 është vendosur miratimi i sheshit për depozitim materiale me sip. 425 m², në favor të shtetasit J. K.; kërkesë datë 6.1.2003, për miratimin e destinacionit dhe kondicioneve urbane të sheshit të ndërtimit nga shtetasi J. K.; pagesë në masën 68.136 lekë për blerje trualli për llogari të Bashkisë Dropull i Poshtëm, derdhur nga shtetasi J. K., në datë 21.7.2003; vendim i Këshillit të Komunës për objektin shesh depozitimi e prodhimi për materiale ndërtimi, me sipërfaqe sheshi 456 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 150 m²; kërkesë datë 11.9.2006, për miratimin e lejes së ndërtimit; leje ndërtimi nr. ***, datë 5.7.2007, me vendim të KRRT-së; dy mandatarëkëtimi, përkatësisht me nr. ***, datë 22.12.2008, dhe nr. ***, datë 22.12.2008, me vlerë 26.700 lekë secila, në favor të komunës Dropull i Poshtëm, për pagesën e shumës prej 1% të vlerës së preventivit prej 2.670.000 lekë; preventiv punimesh për objektin “magazinë në Dh.” nënshkruar nga preventivues A. P., në shumën totale 1.935.850 lekë dhe planimetri e sheshit të ndërtimit.

79. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka bërë me dije se: “Vendi ku pretendohet trualli është origjina e babait tim dhe e ish-bashkëshortit, fshati Dh., S., komuna Dropull i Poshtëm, një fshat malor në emigrim ku jetojnë pesë familje. As unë as familja ime nuk kemi investuar asnjëherë për ndërtimin e ndonjë objekti. Gjithashtu dhe ish-bashkëshorti im e ka blerë këtë truall formalisht, por nuk ka investuar asnjëherë në të”.
80. Gjithashtu, së bashku me përgjigjet e mësipërme subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 4.3.2021, nga komuna Dropull i Poshtëm, e cila ka bërë me dije se nga verifikimi në terren u konstatua se mbi këtë truall nuk është bërë ndërtimi, pavarësisht lejes së ndërtimit dhe pagesës 50% që është kryer në lidhje me të, duke bashkëlidhur disa foto të truallit për të provuar moskryerjen e ndërtimit.
81. Për të vërtetuar sa më sipërcituar, Komisioni iu drejtua Bashkisë Dropull me shkresën nr. *** prot., datë 1.4.2021 dhe shkresën nr. *** prot., datë 5.5.2021, duke i kërkuar informacioni mbi statusin aktual juridik të pasurisë. Bashkia Dropull, me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2021, ka vënë në dispozicion dokumentacionin e përfitimit të këtij trualli, por pa informuar mbi statusin aktual juridik të saj.
82. Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë mundësuar kryerjen e pagesës për blerjen e pasurisë, në favor të Bashkisë Dropull, në shumën 68.136 lekë në vitin 2003³³, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare nga të ardhurat e saj dhe të ish-bashkëshortit nga pagat.
83. Nga sa më sipër, në përfundim ka rezultuar se:
- Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* pasurinë e llojit “shesh ndërtimi”, të ndodhur në komunën Dropull i Poshtëm, e cila nga marrëveshja për ndarjen e pasurisë bashkëshortore ka mbetur në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, duket se subjekti ka kryer fshehje të pasurisë në fjalë dhe/ose deklarim të pamjaftueshëm në deklaratën *Vetting*.
 - Duket se nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimet financiare të përdorura për blerjen e truallit në analizë.
 - Duket se kjo pasuri është përfituar në mënyrë të dyshimtë, referuar kriterëve përcaktuese dhe vijueshmërisë së gjendjes faktike, për sa kohë nuk e ka deklaruar as në deklaratën e vitit 2003 dhe as në deklaratën *Vetting*.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

84. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se kjo pasuri, pavarësisht faktit së është nënshkruar marrëveshja përpara noterit për ndarjen e saj, në bazë të cilës është përcaktuar se do të përfitojë edhe këtë pasuri, kjo marrëveshje është private midis palëve për pasuritë që në fakt ata kishin dhe ishin aktuale, përkatësisht një zyrë dhe një kullotë në K., Gjirokastër, pasi pasuritë e tjera ishin vetëm formale dhe ndarja e tyre u bë nëse ato do të formalizoheshin në të ardhmen për të mos lënë shteg për bisedime, dhe se kjo marrëveshje nuk ka efekt për të tretët. Gjithashtu, referuar informacionit të marrë nga ASHK-ja, kjo pasuri rezulton të jetë me gjendje juridike shtet.

³³ Në vitin 2003 të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortit kanë qenë në masën 909.075 lekë, si dhe shpenzimet e jetesës (bazuar në të dhënat zyrtare të INSTAT-it) në masën 281.592 lekë, nga ku duket se subjekti ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e pagesës prej 68.136 lekësh.

85. Në lidhje me pasurinë në fjalë, referuar edhe vërtetimit të Bashkisë Dropull, nuk është realizuar asnjë ndërtim mbi këtë sipërfaqe. Konkluzioni se kjo pasuri nuk është deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe se ka kryer fshehje të pasurisë, është i padrejtë dhe i pa bazuar në prova, pasi kjo sipërfaqe toke nuk është as juridikisht dhe as faktikisht në pronësi apo në zotërim të subjektit. Kjo pasuri nuk mund të deklarohet në deklaratën *Vetting* pasi nuk është përfituar në kuptim të ligjit dhe duke qenë se nuk është përfituar edhe nuk mund të deklarohet një pasuri që nuk ekziston, nuk është përfituar dhe nuk është zhvilluar.

Vlerësimi i trupit gjykues

86. Në vijim të analizës së konstatimeve të mësipërme dhe të rrethanave të sipërcituara, trupi gjykues, lidhur me këtë truall, çmon se subjekti i rivlerësimit, duke mos deklaruar pasurinë në fjalë në deklaratën *Vetting*, i është shmangur me vetëdije njëkohësisht kontrollit dhe verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve të kryera – duke marrë në konsideratë edhe kryerjen e pagesës për lejen e ndërtimit në lidhje me truallin për investimin mbi këtë pasuri – edhe pse ndërtim i papërfunduar. Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e germës “c”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

87. Lidhur me një analizë të përgjithshme të të tre trojeve të përfituar nga familja e subjektit, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë mospërfshirjen e saj në këto përfitime dhe mosnjohjen e ekzistencës së tyre. Madje, në mënyrë jo bindëse ajo ka shpjeguar se nuk i ka konsideruar si pasuri të përfituara, pasi ka munguar akti final që do të mundësonte regjistrimin e tyre në ASHK. Vlerësimi i trupit gjykues nisët nga fakti që rezulton e provuar se: (i) mbi njërin prej tyre është dhënë një leje ndërtimi e kërkuar nga ish-bashkëshorti i subjektit dhe mbi truallin në fjalë janë nisur punimet e realizimit të një objekti; (ii) prej subjektit janë kryer pagesa pikërisht për blerjen e këtyre trojeve; (iii) ka pasur vendime të këshillit bashkiak që kanë njohur përfitimin e tre trojeve; ndërkohë që (iv) njëri prej këtyre vendimeve është deklaruar i pavlefshëm; dhe pavarësisht kësaj më pas çuditërisht (v) është marrë një tjetër vendim që i ka ridhënë subjektit dhe familjes së saj mundësinë e (ri)zotërimit të këtij trualli; (vi) subjekti pavarësisht se të tre trojet janë përfituar me të njëjtën mënyrë, dikë e ka deklaruar, e dikë tjetër nuk e ka deklaruar – sikur efektet që aktet përkatëse, të njëjta, prodhonin efekte në një rast, por jo në një tjetër rast; (vii) një truall nuk është deklaruar asnjëherë nga subjekti, ndonëse ai ishte përfshirë në marrëveshjen e divorcit të vitit 2014, siç është specifikuar e qartësuar më sipër, që i kalonte në pronësi ekskluzive subjektit të rivlerësimit. Pavarësisht këtij realiteti, subjekti në mënyrë jo bindëse ka shpjeguar se ky akt prodhonte efekte midis palëve, por jo në raport me të tretët, për sa kohë nuk ishte i regjistruar në ASHK. Ky arsyetim bie ndesh me detyrimin ligjor të subjektit për të deklaruar çdo pasuri të paluajtshme apo të luajtshme mbi të cilat gëzohen të drejta reale si *de jure* ashtu/ose *de facto*, pra duke mjaftuar edhe vetëm zotërimi dhe detyrimisht duhej që pasuritë të ishin formalisht të regjistruara në ASHK.

88. Në konkluzion të sa më lart është përshkruar e arsyetuar, trupi gjykues vëren një ndërthurje situatash faktiko-ligjore-administrative që janë pasojë dhe/ose kanë passjellë disa veprime apo mosveprime dhe përfitime të cilat – përpos mosdeklarimit të zotërimit të njërit truall, që subjekti vijonte ta kishte në zotërim totalisht prej vitit 2014, edhe në momentin e deklaratës *Vetting*, çka përbën evidentimin e deklarimeve të pamjaftueshme si në deklaratat vjetore, ashtu edhe në atë *Vetting*, fakt ky që dikton aplikimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, për

mosdeklarim/fshehje të pasurisë – në tërësinë e tyre këto rrethana evidentojnë sjellje të subjektit në shkelje të etikës së gjyqtarit, të cilat kanë cenuar kësisoj edhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, në kuptim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

4. Lidhur me disa pasuri të paluajtshme, të mbetura në pronësi të ish-bashkëshortit të subjektit, pas ndarjes së pasurisë bashkëshortore

4.1 Pasuria e llojit “kullotë”, me sipërfaqe 609 m², ndodhur në K.

89. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2010 se ish-bashkëshorti J.K. ka blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 2.6.2010, nga pala shitëse P. C. pasurinë e llojit “kullotë” me sipërfaqe totale 609 m², në fshatin K., Gjirokastrë, kundrejt shumës 63.336 lekë³⁴, me burim krijimi nga kursimet e familjes.
90. ASHK-ja Gjirokastrë, me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2020, ka vënë në dispozicion kopje të dokumentacionit përkatës³⁵ dhe certifikatën për vërtetim pronësie në emër të shtetasit J. K., të lëshuar më 14.6.2010, për pasurinë e llojit “kullotë”, me sipërfaqe 609 m².
91. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se ish-bashkëshorti i subjektit ka depozituar një kërkesë (pa datë) në ZVRPP-në Gjirokastrë, në të cilën është përshkruar se sipas lejes së ndërtimit të dhënë me vendimin nr. ***, datë 18.1.2013, ka ndërtuar një objekt karburant dhe lokal dhe në datën 6.4.2011 ka paguar shumën 231.626 lekë për taksë efektive në infrastrukturë për ndërtime të reja, në llogari të komunës Dropull i Sipërm, si dhe ka paguar taksën mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror me nr. pasurie ***, për periudhën 18.1.2013 – 18.6.2014.
92. Po ashtu, ish-bashkëshorti i subjektit ka dorëzuar disa fatura të lëshuara për shoqërinë tregtare “K.” sh.p.k., përkatësisht në datat 18.11.2013 (faturë për profile të ndryshme prej gazi dhe çeliku) dhe 9.1.2014 (faturë për saldim dhe montim konstruksioni metalik), të cilat datojnë pas përfundimit të procedurave të zgjidhjes së martesës së subjektit të rivlerësimit me ish-bashkëshortin.
93. Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se në datën 7.3.2013 shoqëria e ish-bashkëshortit të subjektit “K.” sh.p.k., e regjistruar³⁶ në datën 11.2.2013, ka marrë një leje të thjeshtë mjedisore me emërtimin “autorizim mjedisor për aktivitetin lokal, magazinë, ambient shërbimi, karburant dhe distributor”, me adresë në pikën kufitare të kalimit K..
94. Nëpërmjet kontratës së dhurimit nr. ***, datë 13.3.2015, shtetasi J. K. i ka dhuruar shoqërisë tregtare “K.” sh.p.k. pasurinë në fjalë, me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e cila më pas është regjistruar në emër të kësaj shoqërie.

³⁴ Me çmimin 104 lekë/m².

³⁵ Referencat nr. 112, 117, 71, 110.

³⁶ Bazuar në ekstraktin historik të shoqërisë “K.” sh.p.k., në faqen zyrtare www.qkb.gov.al ka rezultuar se shoqëria është themeluar nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit J. K., në datën 6.2.2013, me aktivitet ndër të tjera “hapja e *duty free* dhe tregtimi i mallrave me shumicë dhe pakicë, tregtim i karburanteve me pakicë, si dhe vajrave lubrifikantë dhe të gazit të lëngshëm”. Në bilancin e dorëzuar në QKB për vitin 2013 ka rezultuar se nuk janë realizuar të ardhura dhe shoqëria ka qenë me humbje prej 283.789,98 lekësh.

95. Më pas, shoqërisë “K.” sh.p.k. i është miratuar shitja e truallit shtetëror³⁷, me sip. 371 m², me nr. pasurie ***, , konkluduar me kontratën e shitblerjes së truallit me nr. ***, në datën 11.5.2016, të nënshkruar me Ministrinë e Financave, kundrejt çmimit 91.266 lekë. Në përfundim të këtyre veprimeve, ish-bashkëshorti i subjektit ka bërë bashkimin në ASHK të këtyre dy pasurive në një truall të vetëm, me sip. 980 m².
96. Referuar përshkrimit të bërë në deklaratën noteriale të datës 6.2.2014, për ndarjen e pasurisë bashkëshortore, në të cilën palët kanë deklaruar se mbi pasurinë në analizë [...] është kryer ndërtimi në konstruksion sipas lejes së ndërtimit [...], Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të bëjë me dije mbi shpenzime të mundshme të ndërtimit të objektit “karburant dhe lokal” mbi truallin në fjalë, duke specifikuar kohën dhe mënyrën e kryerjes së tyre, si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për to.
97. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të sa më sipër, është shprehur se: *“Punimet në objektin në fjalë janë kryer nga ish-bashkëshorti nëpërmjet shoqërisë ‘K.’ sh.p.k., e cila është themeluar më 11.2.2013 nga ish-bashkëshorti im. Punimet e para në këtë objekt për llogari të kësaj shoqërie janë kryer në muajin gusht të vitit 2013 (informacion i siguarur pas kontaktit me ish-financierin e shoqërisë). Në këtë periudhë unë isha në proces gjyqësor për zgjidhje martese (proces i cili ka përfunduar në datën 23.9.2013). Për pasojë nuk kisha dijeni në lidhje me këtë shoqëri apo me aktivitetin e saj. Nga ana ime nuk është kryer asnjë investim dhe nuk është dhënë asnjë kontribut në lidhje me këtë shoqëri. Saktësoj se në dijeninë time deri në ditën e sotme nuk ka përfunduar ndërtimi në këtë objekt. Shoqëria e krijuar prej tij nuk ka pasur asnjëherë aktivitet. Objekti edhe sot është vetëm një strukturë metalike e papërfunduar. I njëjti sqarim vlen edhe për pjesën e pyetjes që lidhet me shpenzimet e qirasë së truallit shtetëror që ka qenë minimale. Këto pagesa duhet të jenë kryer nga ish-bashkëshorti im, por unë nuk disponoj asnjë dokumentacion dhe as kam informacion në lidhje me këtë çështje. Arsyeja e mosdeklarimit në DIPP të shpenzimeve është pikërisht fakti se unë nuk kam kryer asnjë shpenzim dhe se të gjitha shpenzimet e kryera nga ish-bashkëshorti im janë kryer gjatë dhe pas periudhës së zgjidhjes së martesës”.*
98. Komisioni, në vijim të veprimeve hetimore të mëtejshme për të identifikuar momentin e saktë të nisjes së ndërtimit dhe për rrjedhojë dhe të kryerjes së shpenzimeve prej familjes së subjektit, i është drejtuar Bashkisë Gjirokastër me shkresën nr. *** prot., datë 1.4.2021, lidhur me dosje të mundshme të praktikave për ndërtimin mbi pasurinë në fjalë, të objektit “karburant dhe lokal”, për të vënë në dispozicion situacione të mundshme, leje shfrytëzimi etj. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, Bashkia Gjirokastër³⁸, me shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2021, ka bërë me dije se kjo pasuri nuk ndodhet në territorin që përfshin Bashkia Gjirokastër.
99. Gjithashtu, Komisioni i ka kërkuar informacion mbi këtë ndërtim edhe Bashkisë Dropull, me shkresën nr. *** prot., datë 1.4.2021, si dhe ridërguar kërkesën me shkresën nr. *** prot., datë 5.5.2021. Në përgjigje të sa më sipër, Bashkia Dropull, me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2021, ka vënë në dispozicion dokumentacionin e disponuar mbi këtë truall dhe ka bërë me dije se statusi aktual juridik i kësaj pasurie është ndërtuar deri në nivel karabina.

³⁷ Tokë kjo, e cila deri në atë moment ishte e marrë me qira nga ish-bashkëshorti i subjektit.

³⁸ Sektori i lejeve, licencave dhe administrimit të pronave publike.

100. Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë mundësuar blerjen e pasurisë në fjalë në qershor të vitit 2010, Komisioni ka përlogaritur të gjitha të ardhurat³⁹, kursimet⁴⁰ dhe shpenzimet e familjes së subjektit deri në atë moment, në përfundim të së cilës ka rezultuar se kanë pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare.
101. Lidhur me ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit me shtetasin P. C., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2020, ka bërë me dije se nuk ka rezultuar ndonjë çështje e gjykuar me këtë shtetas.
102. Nisur nga sa më sipër, ka rezultuar se:
- Duket se subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshorti kanë pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e pasurisë në fjalë.
 - Duket se, me aq sa disponohet nga Komisioni, nuk mund të përcaktohet një moment i saktë i fillimit të kryerjes së punimeve të ndërtimit të objektit “karburant dhe lokal” mbi pasurinë në fjalë, por duket se kanë filluar rreth periudhës së fillimit/zhvillimit të procesit të zgjidhjes së martesës mes subjektit dhe ish-bashkëshortit të saj.

4.2 Shesh ndërtimi, me sipërfaqe 367,8 m², dhënë me vendim të Këshillit Bashkiak Sarandë

103. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri për herë të parë në DIPP-në e vitit 2004, si pasuri e përfitur nga ish-bashkëshorti “si i pastrehë”, me vendimin nr. ***, datë 28.8.1999, të Këshillit Bashkiak Sarandë, e paregjistruar në ZRPP, me vlerë 200.000 lekë.
104. ASHK-ja Sarandë, me shkresën nr. *** prot., datë 25.1.2021, ka bërë me dije se nuk mund të japë informacion për këtë me këto të dhëna. Bazuar në deklaratën noteriale nr. ***, datë 6.2.2014, pasuria në fjalë ka mbetur në pronësi të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.
105. Komisioni i ka kërkuar Bashkisë Sarandë të përcjellë dosjen e pasurisë në fjalë, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 16.4.2021, ka bërë me dije se pasuria e paluajtshme shesh ndërtimi, me sip. 367,80 m², në bllokun ***, parcela ***, është e përfitur nga shtetasi J. S. K., duke vënë në dispozicion vendimin nr. ***, datë 28.8.1999, të Këshillit Bashkiak, si dhe lejen për ndërtim të përkohshëm e planimetrinë e sheshit të ndërtimit.
106. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni, ka rezultuar se kjo pasuri është përfitur nga ish-bashkëshorti i subjektit, me të njëjtin vendim të Këshillit Bashkiak, në të cilin ka përfitur dhe vetë subjekti i rivlerësimit⁴¹.
107. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti, bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, ka rezultuar se për pasurinë shesh ndërtimi të miratuar në favor të subjektit të rivlerësimit, në mars të vitit 2002 është kryer një pagesë prej 192.384 lekësh në favor të Bashkisë Sarandë. Ndërkohë që për këtë pasuri, në dokumentacionin e përcjellë nga Bashkia Sarandë nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion/informacion mbi ndonjë pagesë të kryer. Por nisur nga fakti se sipërfaqet e përfituara të shesheve të ndërtimit janë të

³⁹ Në përlogaritje janë përfshirë vetëm shumat e tërhequra nga llogaria bankare e pagës së subjektit të rivlerësimit, pasi nga shqyrtimi i llogarive të ish-bashkëshortit nuk ka rezultuar ndonjë tërheqje e kryer prej tij gjatë periudhës janar – maj 2010.

⁴⁰ Në kursimet e disponuara *cash* janë konsideruar si burim i ligjshëm për blerjen e pasurisë në analizë vetëm ato kursime të cilat mund të disponoheshin me burime të ligjshme financiare. Për metodikën, referojuni analizimit të kursimeve *cash* në pikën 7 dhe 9 të këtij relacioni.

⁴¹ Lutemi referojuni pasurisë nr. 2, shesh ndërtimi me sip. 400 m², ndodhur në Sarandë.

përafërta, nga Komisioni është konsideruar e kryer edhe prej ish-bashkëshortit të subjektit, së paku e njëjta pagesë në favor të Bashkisë Sarandë.

108. Nga analiza financiare e kryer për periudhën 2001 – shkurt 2002⁴² ka rezultuar se subjekti dhe ish-bashkëshorti kanë pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e të dy pagesave për trojet e përfituara.

109. Nga sa më sipër, në përfundim ka rezultuar se:

- Duket se subjekti dhe ish-bashkëshorti kanë pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e pagesave të trojeve të përfituara me vendim të Këshillit Bashkiak Sarandë.
- Duket se kjo pasuri është përfituar në mënyrë të dyshimtë, referuar kriterëve përcaktuese dhe vijueshmërisë së gjendjes faktike, për sa kohë familja e subjektit ka përfituar njëkohësisht tre sheshe ndërtimi (nga të cilët dy me të njëjtin vendim të Këshillit Bashkiak). Për rrjedhojë, duket se nëpërmjet përfitimeve të mësipërme, subjekti ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

110. Edhe për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka prapësuar konstatimet lidhur me sa më sipër, me argumentin e trajtuar në pasurinë nr. 2, shesh ndërtimi me sip. 400m², në Sarandë, duke shpjeguar se trulli është përfituar në mënyrë të ligjshme dhe se sipas vërtetimit të ASHK-së Sarandë kjo pasuri figuron në gjendje juridike shtet. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se familja ka përfituar me procedura të rregullta dy sheshe më vete, por asnjëherë nuk ka fituar pronësinë mbi këto troje, pasi aktualisht janë të pazhvilluara dhe nuk janë zotëruar *de facto* prej tyre⁴³.

Vlerësimi i trupit gjykues

111. Lidhur me përfitimin njëkohësisht të tre shesheve të ndërtimit (nga të cilët dy me të njëjtin vendim të Këshillit Bashkiak), nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj – ashtu sikurse është evidentuar edhe më sipër, nisur nga dinamika dhe mënyra e dyshimtë e përfitimit të tyre dhe nga marrja e lejes së ndërtimit, si dhe kryerja e pagesave përkatëse për përfitimin e shesheve dhe për lejen e ndërtimit me qëllim investimin në Bashkinë Sarandë – arrihet në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet veprimeve apo mosveprimeve të saj, ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe ka dështuar të provojë të kundërtën apo të japë shpjegime bindëse për të kundërtën e rezultateve të Komisionit.

5. Apartament banimi me sipërfaqe 98 m², në lagjen “*”, Gjirokastrë**

112. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, ka rezultuar se në regjistrin noterial shqiptar është regjistruar një veprim i kryer nga subjekti i rivlerësimit, në datën 4.3.2014, me përshkrimin “kontratë porosie”, pranë noterit B. Xh. Në vijim të veprimeve hetimore, Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 5.10.2020, i ka kërkuar noterit B. Xh. të

⁴² Në vijim është analizuar mundësia për kryerjen e shpenzimeve për blerjen e trullit nga subjekti.

⁴³ Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se familja e ish-bashkëshortit ka bërë kërkesë që në vitin 1993 dhe se ka përfituar një shesh ndërtimi në vitin 1995, e më pas kjo pasuri është anuluar në tërësi me vendimin e gjykatës. Më pas, me vendimin nr. ***, datë 25.8.1999, është ribërë kërkesë për plotësimin e nevojave të familjes së ish-bashkëshortit. Gjithashtu, ka shpjeguar se nuk ka qenë në dijeni të veprimeve që kryente ish-bashkëshorti dhe familja e tij.

paraqesë kontratën e porosisë së nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit me referencat nr. ***, datë 4.3.2014.

113. Kjo kontratë porosie ishte nënshkruar ndërmjet subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e palës porositëse, dhe shtetas L. K., në cilësinë e investitorit, për porositjen e një apartamenti me sip. 98 m² të ndodhur në katin e pestë të një banese masive në lagjen “***”, Gjirokastër.
114. Bazuar në kontratën e porosisë së përcjellë nga noteri, çmimi total i shitjes është përcaktuar në shumën 4.500.000 lekë, nga të cilat në datën 4.3.2014, porositësja Mirela Iliopullo ka derdhur për llogari të investitores L. K. shumën prej 4.200.000 lekësh dhe pjesa e mbetur do të shlyhej deri në datën 10.9.2014.
115. Më pas, është konstatuar se për të njëjtin apartament, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar një tjetër kontratë porosie me nr. ***, në datën 20.12.2016, por në emër të babait të saj, i përfaqësuar me prokurë të posaçme nga subjekti i rivlerësimit⁴⁴, kundrejt të njëjtit çmim prej 4.500.000 lekësh.
116. Lidhur me sa më sipër, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime, e cila në përgjigje të saj është shprehur se: *“Kontrata e porosisë së vitit 2014 ka qenë nënshkruar nga ana ime për llogari të babait tim J. I. dhe për pasojë dhe pagesa e kryer ishte për llogari të babait dhe me para të dhëna nga prej tij. Kjo kontratë është revokuar në datën 15.12.2016, me anë të dokumentit revokim kontratë porosie nr. ***. Pra, unë në këtë rast kam funksionuar si ndërmjetëse ose ndihmëse për të përfunduar transaksionin, duke qenë se babai im nuk ndodhej në Shqipëri. Kjo është dhe arsyeja e mosdeklarimit të kontratës së porosisë dhe pagesës përkatëse, pra fakti se nuk kishim të bënim me pasuri timen dhe për pasojë nuk kisha çfarë të deklaroja në deklaratën time të pasurisë. Pagesat janë kryer me lekë në dorë dhe aktualisht nuk disponoj dokumentacion. Burimet e ligjshme të të ardhurave kanë qenë të ardhurat e babait tim J. I. dhe mamasë sime znj. V. I.. Prindërit e mi kanë qenë mësues, kanë dalë në pension në moshë të re dhe janë larguar në emigracion që prej vitit 1992. Fillimisht kanë jetuar në Greqi në qytetin e Korfuzit dhe pas vitit 2010 janë larguar në SHBA, pasi babi im është shtetas amerikan, duke qenë se gjyshi im M. I. ka jetuar, punuar dhe ndërruar jetë në SHBA. Gjithashtu, prindërit e mi kanë shtetësi greke. Në Greqi prindërit e mi kanë punuar që prej vitit 1992 deri në vitin kur janë larguar në SHBA. Dua të theksoj se prindërit e mi kanë pasur të ardhura nga trashëgimia e ardhur nga gjyshi im nga SHBA-ja rreth 45.000 USD, që e konvertuar është një shifër e konsiderueshme, shitja e një shtëpie në fshatin Dhuvjen, Gjirokastër, si dhe kursime nga puna në emigracion. Gjithashtu, gjatë gjithë viteve të emigrimit prej vitit 1992 të ardhurat nga pensionet e tyre kurseheshin pasi ata nuk jetonin në Shqipëri. Prindërit e mi gjatë viteve kanë pasur kursime dhe me prokurat që paraqes tregon se ata na jepnin të drejta për kryerjen e veprimeve në banka⁴⁵ në kohën që nuk mund të udhëtonin. Të ardhurat e tyre*

⁴⁴ Babai i subjektit të rivlerësimit J. I. ka autorizuar znj. Mirela Iliopullo, nëpërmjet prokurës së përgjithshme të datës 20.10.2016, të lëshuar në Worcester, MA, SHBA, për kryerjen e veprimeve ligjore dhe administrative bankare për blerje dhe shitje të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme në emër të tij.

⁴⁵ Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se në datën 21.7.2016, me prokurën apostile nr. ***, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr shumën 10.100 euro nga llogaria e babait në “Raiffeisen Bank”. Komisioni i ka kërkuar subjektit të vendoste në dispozicion prokurën apostile të sipërcituar, si dhe të bënte me dije nëse kjo shumë ishte përdorur prej saj dhe për çfarë qëllimi. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit, ka paraqitur prokurën e posaçme të datës 17.6.2016, përpara noterit publik të shtetit Massachusetts, SHBA të prindërve të saj, të cilët e kanë autorizuar për të tërhequr shumat në depozitat e tyre në “Alpha Bank” dhe “Raiffeisen Bank”, si dhe është shprehur se kjo shumë nuk është përdorur prej saj për krijimin e

janë të mjaftueshme për blerjen e një apartamenti. Ata edhe në momentin e punësimit të tyre kanë pasur paga të larta për kohën dhe pjesa e trashëgimisë, por edhe kursime të tjera është mbartur prej tyre në vite”. Subjekti ka paraqitur dokumentacionin mbi të ardhurat e tyre⁴⁶.

117. Po ashtu, së bashku me përgjigjet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e provës një dokument revokim kontrate porosie, me nr. ***, të datës 15.12.2016, të nënshkruar ndërmjet saj dhe investitores L. K..
118. Për pasurinë në fjalë ka rezultuar se më pas është nënshkruar edhe kontrata e shitblerjes me nr. ***, në datën 16.3.2018⁴⁷, e konfirmuar edhe nga ASHK-Gjirokastrë, me shkresën nr. *** prot., datë 27.2.2020⁴⁸, e cila ka bërë me dije se në emër të babait të subjektit të rivlerësimit J. I. figuron e regjistruar pasuria e llojit “apartament”, me sip. 98 m², me nr. ***, e blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 16.3.2018.
119. Lidhur me konfliktin e interesit, subjekti i rivlerësimi ka deklaruar se nuk ka asnjë marrëdhënie apo konflikt interesi me asnjë prej personave të përmendur si palë shitëse⁴⁹ dhe as prindërit e saj. Nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2014 është konstatuar se subjekti nuk ka deklaruar kryerjen e veprimit juridik të nënshkrimit të kontratës së porosisë dhe kryerjen e shpenzimit përkatës të pagesës prej 4.200.000 lekësh të blerjes së apartamentit të sipërcituar. Për më tepër, nga hetimi administrativ dhe nga dokumentacioni i përcjellë nga subjekti nuk ka rezultuar ndonjë dokument që të provojë dërgimin e parave nga prindërit të subjektit të rivlerësimit dhe as ndonjë dokument të kohës që të provojë blerjen e këtij apartamenti për llogari të prindërve të saj.
120. Për rrjedhojë e si pasojë e sa më sipër, Komisioni ka përlllogaritur mundësinë e subjektit për blerjen e kësaj pasurie me të ardhurat e saj deri në datën 4.3.2014 dhe duke qenë se nuk ka deklaruar ndonjë pakësim të gjendjes së disponuar *cash* në banesë, por ka deklaruar mbartjen dhe shtimin e saj në vitin 2014, Komisioni nuk e ka përfshirë si burim për blerjen e kësaj pasurie. Trupi gjykues, në këtë pikë, vëren se edhe në rast se do të konsiderohej nga Komisioni përdorimi i kësaj gjendjeje të disponuar nga subjekti në *cash* në fund të vitit 2013, do të passillte zerimin e gjendjes *cash* në këtë vit dhe pamundësinë për t’i depozituar në “Alpha Bank” në vitin 2016⁵⁰ dhe kësisoj kjo mungesë financiare do

ndonjë pasurie, por u është dhënë prindërve në momentin e ardhjes në Shqipëri. Arsyeja e tërheqjes ishte për shkak të lajmeve për krizë në sistemin bankar, prindërit patën frikë të linin paratë në bankat shqiptare dhe kanë kërkuar t’i tërhiqte dhe t’i ruante në banesën e saj.

⁴⁶ (i) Vërtetim nr. *** prot., datë 26.2.2021, nga ISSH-ja Gjirokastrë për të ardhurat nga pensionet e pleqërisë së prindërve; (ii) deklaratë nga shtetasja V. D., e cila ka deklaruar se prindërit e subjektit i kanë shitur banesën e ndodhur në fshatin Dh., Gjirokastrë, në vitin 1990, kundrejt shumës 200.000 lekë; (iii) praktika e trashëgimisë së lënë nga gjyshi i subjektit, sipas së cilës më 16.3.1970, shuma 23.508,10 USD e ardhur në favor të trashëgimtarëve të të ndjerit M. E. është ndarë mes 4 trashëgimtarëve, nga të cilat pjesa takuese e babait të subjektit J. I. ka qenë 5.224,03 USD. Nga kjo shumë është zbritur 5% komisioni i shoqërisë komisionare dhe shpenzimet në masën 335 lekë; (iv) prokurë nr. ***, datë 11.11.2010, e lëshuar nga prindërit e subjektit, të cilët kanë caktuar dy vajzat e tyre, mes të cilave dhe subjekti, për të tërhequr pensionet e tyre të pleqërisë; (v) prokurë në gjuhën greke (përkthyer në shqip), me nr. ***, e datës 11.5.2012, lëshuar në Greqi nga prindërit e subjektit, me anë të së cilës kanë autorizuar subjektin që të tërheqë nga llogaritë e tyre bankare apo pensionin mujor të tyre; (vi) prokurë e posaçme e datës 13.1.2021, përpara noterit publik në SHBA, të prindërve të subjektit, të cilët kanë autorizuar shtetasin Th. P. për të kërkuar informacion mbi llogaritë e tyre bankare në bankat greke; si dhe (vii) printim i një libeze kursimesh në emër të nënës së subjektit, në Bankën e Qipros, sipas së cilës është depozituar një shumë prej 20.000 euro në datën 5.11.2010 dhe tërhequr në datën 6.5.2011.

⁴⁷ Referuar kontratës së shitblerjes së vitit 2018, blerësi J. I. është përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit me prokurën e përgjithshme të datës 20.10.2016, e cila ka nënshkruar kontratën e shitjes.

⁴⁸ Në përgjigje të kërkesës së Komisionit me nr. *** prot., datë 27.1.2020.

⁴⁹ “L. K.” Person Fizik, L. R. K. dhe M. T. K..

⁵⁰ Duke rezultuar në një balancë negative në atë vit me 1.388.753 lekë.

të spostohej më tej si pamundësi për të rikrijuar kursimet e deklaruara në deklaratën *Vetting*⁵¹, duke mos ndryshuar rezultati i përgjithshëm i pamjaftueshmërisë së mjeteve monetare të ligjshme.

121. Në këto kushte, pasi u verifikuan llogaritë bankare, ka rezultuar se subjekti ka tërhequr gjatë periudhës 1.1.2014 – 4.3.2014 vetëm shumën 52.000 lekë, të cilat nuk mjaftojnë as për mbulimin e shpenzimeve të jetesës për një periudhë 2-mujore. Në përfundim, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për të gjithë vlerën e blerjes së kësaj pasurie në shumën 4.200.000 lekë.
122. Nëpërmjet pyetësorit nr. 3, Komisioni i ka kërkuar subjektit të bëjë me dije nga kush dhe për çfarë përdoret apartamenti i prindërve, e cila në përgjigje të sa më sipër është shprehur se në këtë apartament banon mbesa⁵² e saj me bashkëshortin, por nuk disponojnë ndonjë kontratë.
123. Nisur nga sa më sipër, Komisioni i ka bërë me dije subjektit për këtë pikë rezultatet si vijon:
 - Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2014 këtë pasuri, veprimin juridik të kryer prej saj, si dhe shpenzimin përkatës për kryerjen e pagesës prej 4.200.000 lekësh, duke e fshehur atë.
 - Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për të gjithë vlerën e blerjes së kësaj pasurie prej 4.200.000 lekësh.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

124. Lidhur me konstatimet e Komisionit për mosdeklarimin e veprimit juridik të sipërcituar, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se apartamenti në fjalë rezulton të jetë në emër të babait të saj dhe është në pronësi të tij, fakt ky që do të mjaftonte për të konkluduar në lidhje me pronësinë, e për pasojë, të analizohej mundësia financiare e prindërve për blerjen e tij. Kontrata e blerjes së apartamentit është firmosur në emër të babait dhe për pasojë nuk mund të konkludohet se apartamenti është pronë e saj vetëm duke u bazuar në një kontratë porosie tashmë të revokuar dhe për pasojë pa efekte juridike.
125. Sa i përket mosdeklarimit në DPV-në e vitit 2014, kjo vjen pikërisht për faktin se pasuria në fjalë nuk është e saj, dhe bazuar në nenin 32/4 të ligjit 84/2016 deklaratimet e bëra në DVP-të vjetore duhet të vlerësohen si prova, pasuri e cila nuk është deklaruar, pasi është e babai të saj dhe jo e subjektit të rivlerësimit.
126. Për të provuar sa më sipër përshkruar, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion mandatin e parë të muajit maj të vitit 2013, në shumën 20.000 USD, paguar nga babai J. I.; mandatin e dytë në shumën 2.100.000 lekë, paguar në shkurt të vitit 2014 nga bashkëshorti i motrës së subjektit A. G. për llogari të babit të subjektit; mandati i tretë në shumën 300.000 lekë, në shkurt të vitit 2018, paguar nga bashkëshorti i motrës A. G. për llogari të babait. Nga këto mandatarkëtime rezulton qartë se apartamenti objekt hetimi nuk është në pronësi të saj dhe se për blerjen e tij nuk janë përdorur mjetet e saj monetare, por ato të prindërve⁵³.

⁵¹ Në shumën -1.400.000 lekë.

⁵² Shtetasja K. G..

⁵³ Subjekti i rivlerësimit ka depozituar gjithashtu, nëpërmjet prapësimeve, raportin e audituesit ligjor.

Vlerësimi i trupit gjykues

127. Komisioni vlerëson së pari të vërë në dukje faktin se mosdeklarimi nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2014 të veprimit juridik të kryer prej saj, siç është nënshkrimi i kontratës së porosisë në emrin e saj në vitin 2014 për blerjen e apartamentit në fjalë, konsiderohet si një mosveprim/mosdeklarim i qëllimshëm për të fshehur atë fakt dhe për të shmangur kësisoj kontrollin dhe kryerjen e verifikimeve përkatëse që lidhen edhe me burimin e ligjshëm të shumës së paguar prej 4.200.000 lekësh. Për më tepër që, edhe nëse do të konsiderohej e mirëqenë se pagesa ishte kryer më të ardhura me burim nga prindërit e saj, nuk rezultoi e provuar me dokumentacion ligjor provues mundësia financiare e prindërve të subjektit dhe dërgimi i pretenduar i parave nga prindërit tek subjekti dhe as ndonjë dokument tjetër i kohës që të provojë blerjen e këtij apartamenti për llogari të prindërve të subjektit. Në të kundërt, ndonëse subjekti përgjatë seancës dëgjimore ka pohuar se kishte një prokurë të përgjithshme (së bashku me të motrën), të lëshuar nga babai me të cilën ajo legjitimohej që të porosiste pasurinë në fjalë dhe të kryente pagesa në emër e për llogari të babait, kjo tezë rezultoi e dështuar, së paku për tri arsye, duke evidentuar mospërputhjen e fakteve me shpjegimet e subjektit, dhe konkretisht: (i) prokura e cituar nuk ishte e përgjithshme por e posaçme dhe i jepte tagër subjektit dhe motrës së saj vetëm për të tërhequr pensionet e prindërve dhe jo për të kryer veprime të tjera juridiko-civile/tregtare për llogari të tyre; (ii) nëse kjo prokurë jepte tagër për nënshkrimin e një kontrate porosie e për pagesa të shumave të rëndësishme monetare, nuk ka logjikë mospërdorja/mospërshkrimi i kësaj prokure në kontratën e porosisë dhe për rrjedhojë, porosia e pasurisë dhe pagesa përkatëse të kryhej në emër të babait të subjektit dhe jo të kësaj të fundit; (iii) prindërit e subjektit nuk kishin burime financiare dhe nuk kishin interes të investonin në Shqipëri, për sa kohë jetonin në SHBA, dhe as nuk është provuar transferimi i mundshëm prej tyre i parave drejt subjektit.
128. Ndërsa, lidhur me burimet për blerjen e pasurisë në fjalë, Komisioni vlerëson se nuk rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit të ketë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e saj, duke konkluduar se ajo (sikurse edhe prindërit e saj) kishte një pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për të gjithë vlerën e blerjes së kësaj pasurie në shumën 4.200.000 lekë.
129. Në përfundim dhe për rrjedhojë të sa është konstatuar, analizuar dhe arsyetuar më lart, trupi gjykues mbërrin në konkluzionin se nuk ka ndonjë logjikë ekonomike dhe të qenësishme në investimin e prindërve të subjektit në këtë pasuri, për aq kohë sa kryerja e pagesës referuar kontratës së porosisë është bërë nga subjekti i rivlerësimit. Ndonëse në parashtrimet/prapësimet e sjella nga subjekti u paraqitën tri mandatarkëtime të kryerjes së pagesave nga persona të tjerë të cilat u depozituan vetëm në fazën përfundimtare dhe nuk u pretendua/përmend prezenca e tyre në asnjë fazë të hetimit si pagesa të kryera prej tyre, ndryshe dhe në kundërshtim nga sa përshkruhet në kontratën e porosisë të nënshkruar nga subjekti përpara një noteri publik. Për rrjedhojë, mandatet në fjalë nuk mund të zhbëjnë përmbajtjen e kontratës së firmosur nga subjekti dhe as mund të provojnë të kundërtën e saj, qoftë për forcën provuese, ashtu edhe për besueshmërinë dhe përputhjen e logjikshme dhe në harmoni me faktet e tjera dhe kontekstin specifik. Në këto kushte, mosdeklarimi i këtij veprimi juridik dhe financiar (kontrata e porosisë dhe pagesa përkatëse) gjen shkak dhe cilësohet si një tentativë për të shmangur veprimin juridik në fjalë në periudhën përkatëse dhe jo sepse nuk konsiderohej si një detyrim për t'u deklaruar, për faktin që apartamenti në fjalë nuk mund të përdorej nga prindërit e

subjektit, apo që nuk mund të ishte si një investim prej tyre, për sa kohë nuk i dispononin mjetet e nevojshme monetare për të bërë një investim të tillë, dhe për faktin që prej një periudhe të gjatë kohore (e aktualisht) nuk jetonin në qytetin e Gjirokastrës. Në vijim e për rrjedhojë të sa më sipër, trupi gjykues krijon bindjen se, sikurse në momentin e porosisë subjekti ka vepruar *de jure* dhe *de facto* në emrin e vet, duke e riparë pozicionin në funksion të pamundësisë që të justifikonte të ardhurat e ligjshme duke vepruar me revokimin e kontratës së porosisë, dhe duke e kaluar në emër të babait, këtë herë vetëm *de jure*, pasi *de facto* apartamenti vlerësohet të jetë ende i subjekti i rivlerësimit, pasi dyshimet e arsyeshme dhe logjika çon në konkluzionin se ajo ka kryer fshehje të pasurisë apartament banimi me sip. 98 m², me vendndodhje në lagjen “****”, Gjirokastrë.

6. Lidhur me automjetin tip “Mercedes-Benz” me targa SR * dhe automjetin tip “Mercedes-Benz” me targa GJ *** të familjes së subjektit të rivlerësimit përpara dorëzimit të deklaratës Vetting**

130. Në DIPP-në e vitit 2004 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pronësinë e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa SR ***, në emër të ish-bashkëshortit, pasuri kjo e krijuar në vitin 2000, me vlerë 500.000 lekë. Ky automjet është blerë me anë të marrëveshjes së datës 7.10.2000 nga shtetasi A. D., kundrejt çmimit prej 2.800 marka gjermane, si dhe është paguar tarifa e zhdoganimit prej 195.804 lekësh, me një vlerë totale prej 383.054 lekësh.
131. Lidhur me diferencën midis çmimit që ka rezultuar i paguar nga ish-bashkëshorti i subjektit dhe vlerës së deklaruar në DIPP-në e vitit 2004, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka bërë me dije se kjo diferencë ka qenë shuma e shpenzuar nga ish-bashkëshorti për transportin e automjetit nga Gjermania. Lidhur me mosdeklarimin në vitin 2003, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka shpjeguar se nuk e kishte kuptuar drejt mënyrën e plotësimit të deklaratës së parë të vitit 2003 dhe për këtë arsye e ka shtuar në deklaratën e vitit 2004⁵⁴.
132. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit mbi burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar se kanë qenë kursimet familjare nga të ardhurat nga pagat. Nga analiza financiare e kryer deri në fund të vitit 2000 ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, së bashku me ish-bashkëshortin kanë realizuar të ardhura totale në masën 1.394.473 lekë. Pas përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës për të njëjtën periudhë ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për blerjen e pasurisë në fjalë, me burime të ligjshme financiare.
133. Lidhur me marrëdhënie të mundshme familjare/shoqërore apo të çfarëdolloji tjetër, përfshirë edhe konfliktin e mundshëm të interesave me palën shitëse dhe palën blerëse të automjetit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se me shtetasit në fjalë nuk ka ndonjë lidhje familjare apo të çfarëdolloj tjetër dhe në dijeninë e saj as ish-bashkëshorti. Në përgjigje të shkresës së Komisionit me nr. *** prot., datë 5.5.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2021, ka bërë me dije se nga verifikimi i regjistrave civilë dhe penalë për vitet 2008 – 2019 nuk rezulton të ketë vendime të dhëna për shtetasit Dh. C. (K.) dhe A. D..

134. Nga sa më sipër ka rezultuar se:

⁵⁴ Në DIPP-në e vitit 2005 subjekti ka deklaruar shitjen e kësaj pasurie, kundrejt çmimit 250.000 lekë, me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 18.4.2005, sipas së cilës ish-bashkëshorti J. K. ka shitur automjetin blerësit Dh. C. (K.).

- Duket se nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie.

6.1 Automjet tip “Mercedes-Benz” me targa GJ ***

135. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2005 blerjen e automjetit me targa GJ ***, kundrejt vlerës totale 527.016 lekë. DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 14.12.2020, ka bërë me dije se në emër të subjektit të rivlerësimit nuk ka automjet të regjistruar⁵⁵, ndërsa automjeti me targa GJ *** është i regjistruar në emër të shtetasit J. K., duke bashkëlidhur edhe dosjen e dosjen përkatëse të tij.
136. Automjeti ka rezultuar se është blerë me faturën e datës 18.4.2005, lëshuar nga shoqëria e huaj “J.” sprl, kundrejt çmimit 2.500 euro, si dhe është kryer pagesa e tarifës së zhdoganimit në datën 6.5.2005. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se si burim krijimi për këtë pasuri kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e automjetit të disponuar më parë, me targa SR 2846 B dhe pjesa tjetër nga kursimet familjare.
137. Komisioni ka përlllogaritur të ardhurat e familjes për të përcaktuar mundësinë e përballimit të çmimit të blerjes së automjetit të ri prej 2.500 euro, me kursimet familjare të periudhës janar 2005 – maj 2005, të cilat kanë rezultuar në masën 512.431 lekë. Pas përlllogaritjes së shpenzimeve për të njëjtën periudhë ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për blerjen e pasurisë në fjalë me burime të ligjshme financiare.
138. Lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesave, subjekti i rivlerësimit ka pohuar se me asnjë nga shtetasit në fjalë nuk ka ndonjë lidhje familjare apo të çfarëdolloj tjetër. Në përgjigje të shkresës së Komisionit me nr. *** prot., datë 5.5.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2021, ka bërë me dije se nga verifikimi i regjistrave civilë dhe penalë për vitet 2008 - 2019 nuk rezulton të ketë vendime të dhëna nga kjo gjykatë.
139. Nga sa më sipër, ka rezultuar se:

- Duket se nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie.

7. Gjendje në llogarinë bankare në “Alpha Bank”

140. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* gjendjet në llogaritë e saj bankare në “Alpha Bank”, përkatësisht në vlerat 14.998 euro, 64.862 lekë dhe 2 USD, me burim krijimi të ardhurat nga pagat. Po ashtu, në DIPP-në e vitit 2016 ka deklaruar shtimin e llogarisë në euro, me të ardhurat nga pagat ndër vite (kursimet) e mbajtura *cash* dhe të depozituara në bankë gjatë vitit 2016.
141. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni është konfirmuar depozitimi i shumës totale prej 15.000 euro në llogari të subjektit në “Alpha Bank”, përkatësisht nga 5.000 euro në datat 5.10.2016, 14.10.2016 dhe 18.10.2016.
142. Lidhur me mënyrën e deklarimit të gjendjeve në banesë, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegimet e saj, e cila në përgjigje të saj është shprehur se: *“Nuk kam përfshirë në DPV deri në vitin 2007 kursimet familjare, pasi nuk e kisha kuptuar se ky element duhet të përfshihej. Nga viti 2008 e në vazhdim kam përfshirë kursimet familjare në vlerën e tyre totale për çdo vit. Sqaroj se shumt e*

⁵⁵ AMF-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 17.2.2020, ka informuar se në emër të shtetases Mirela Iliopullo ekzistojnë TPL të prera gjatë periudhave 27.3.2019 – 26.3.2020 dhe 5.4.2019 – 4.4.2020. Nga kontrolli në faqen e zyrtare të AMF-së, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka prerë policë sigurimi për automjetin tip “NISSAN, QASHQAI”, me targa AA *** dhe nr. shasie ***.

deklaruar nga ana ime nga viti 2008 e në vazhdim ishin llogaritur me përfaqësi, nuk mbaja ndonjë regjistrim në lidhje me këtë çështje dhe i referohen totalit të likuiditeteve të disponuara. Ndërkohë nuk kam përfshirë asnjëherë pakësime të mundshme të likuiditeteve nga viti i mëparshëm, pasi përsëri nuk e kisha të qartë se si duhej deklaruar”.

143. Nisur nga shpjegimet e mësipërme, por dhe nga deklarimi i subjektit në DIPP-në e vitit 2014, në të cilin janë deklaruar likuiditetet e vitit, e përgjithshmeja ndër vite si dhe fakti që një pjesë e tyre janë në llogarinë e pagës në “Societe Generale Albania Bank” (sot OTP Bank), Komisioni ka përlllogaritur gjendjen e disponuar *cash* në banesë, duke konsideruar shumën e deklaruar në fund të çdo viti si një shtesë të likuiditeteve⁵⁶ totale të disponuara në çdo fund viti.
144. Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë mundësuar kursimin e shumës në fjalë, referuar analizës financiare, si dhe mungesave të rezultuara⁵⁷, deri në këtë fazë të hetimeve, Komisioni ka përlllogaritur si burim të ligjshëm për këtë pasuri kursimet e mbledhura të familjes së subjektit, të cilat mund të mbuloreshin me burime të ligjshme financiare. Në vijim të sa më sipër, Komisioni ka analizuar shtesat e kursimeve të deklaruar për çdo vit, për sa prej tyre familja e subjektit ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare, duke pasur në vëmendje shtesën e deklaruar, si dhe mungesën financiare të rezultuar nga analiza financiare⁵⁸ në fund të çdo viti.
145. Në përfundim të sa më sipër, ka rezultuar se në fund të vitit 2015 subjekti i rivlerësimit mund të dispononte kursime *cash*, të justifikuar me burime të ligjshme financiare, në shumën 2.929.510 lekë⁵⁹, të cilat duket se e mbulojnë shumën e depozituar në “Alpha Bank” prej 15.000 euro. Ndërsa, sa i përket gjendjeve në llogaritë e subjektit në monedhat lekë dhe USD në “Alpha Bank”, nga verifikimi i lëvizjeve bankare është konstatuar se ato rrjedhin nga shuma të depozituara për pagesën e kartës së kreditit (99.500 lekë nga subjekti në datën 24.01.2011 dhe 200.000 lekë nga vajza e subjektit M. K. në datën 23.12.2011) apo për t’iu dërguar vajzës së saj në SHBA (transferuar 4.053 USD në datën 30.4.2012, në favor të vajzës, me përshkrimin “për studime”).
146. Lidhur me këto shuma të depozituara, nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarive bankare nuk është konstatuar ndonjë tërheqje e konsiderueshme në këto shuma as prej subjektit dhe as prej ish-bashkëshortit të saj, por gjendjet e disponuara *cash* në banesë të deklaruar në vitet paraardhëse, si dhe tërheqjet e kryera nga llogaritë përkatëse të pagave duket se i mbulojnë shumat e depozituara.

⁵⁶ Duke përfshirë gjendjet e disponuara në llogaritë bankare të subjektit dhe të ish-bashkëshortit deri në vitin 2013 (kur kanë zgjidhur martesën) dhe më pas janë konsideruar vetëm gjendjet në llogaritë e subjektit të pagës dhe të të ardhurave nga qiradhënia.

⁵⁷ Për mungesat e burimeve të ligjshme, të rezultuara nga analiza financiare ndër vite, referoju aneksit nr. 1 të këtij relacioni.

⁵⁸ Nga ku, në rastet kur mungesa financiare e rezultuar nga analiza është më e lartë se gjendja e pretenduar *cash* e vitit, e gjithë shtesa e pretenduar në atë vit është konsideruar me burime jo të ligjshme financiare. Ndërkohë, në vitet kur mungesa financiare është më e ulët se gjendja *cash* e pretenduar e vitit është konsideruar në varësi të rasteve si vijon: (i) kur mungesa financiare është më e ulët se gjendja *cash* e pretenduar dhe diferenca e tyre është më e vogël se shtesa e pretenduar e gjendjes *cash* të vitit, është konsideruar vetëm diferenca e tyre, me burime të ligjshme financiare; dhe (ii) kur mungesa financiare është më e ulët se gjendja *cash* e pretenduar, por diferenca e tyre është më e lartë se shtesa e pretenduar e gjendjes *cash* e vitit, e gjithë shtesa e vitit është konsideruar me burime të ligjshme financiare.

⁵⁹ Në rast se do të pretendohet nga subjekti (në pikën nr. 5 të këtij relacioni) përdorimi i kursimeve *cash* të vitit 2013 prej 1.530.031 lekësh për blerjen e pasurisë në vitin 2014, zerimi i gjendjes *cash* në vitin 2014 do të passillte një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej 1.388.753 lekësh në vitin 2016, për të depozituar shumën prej 15.000 euro në llogarinë në “Alpha Bank”.

147. Nga sa më sipër, në përfundim ka rezultuar se:

- Duket se gjendjet e deklaruara nga subjekti në deklaratën *Vetting* përputhen me dokumentacionin e administruar.
- Nga analiza financiare duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për depozitimin e kryer në vitin 2016, të shumës 15.000 euro në “Alpha Bank”. Po ashtu, duket se subjekti ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare edhe për depozitimet e tjera të kryera në llogaritë në monedhat lekë dhe USD.

8. Gjendje në llogaritë bankare në vlerat 50.819 lekë dhe 83 USD në BKT

148. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* gjendjet në llogaritë bankare në “Bankën Kombëtare Tregtare”, përkatësisht në vlerat 50.819 lekë dhe 83 USD, me burim krijimi nga të ardhurat nga qiradhënia.

149. Nga kontrolli në lëvizjet bankare të llogarive të mësipërme, është konfirmuar burimi i krijimit të gjendjes së llogarisë në lekë, me të ardhurat nga qiradhënia e zyrës, të transferuara nga qiramarrësi, subjekti politik “LSI Gjirokastrë”, duke filluar nga qershori i vitit 2014 e në vijim, të ardhurat e përfituara në vitin 2014, të cilat nuk u përfshinë në analizën financiare si të ardhura të ligjshme, për sa kohë nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

150. Ndërsa, llogaria në USD rezulton të jetë krijuar me shuma të depozituara nga subjekti, të cilat janë transferuar më pas për llogari të vajzës së saj në SHBA, me përshkrimin “pagesë për shkollë”, përkatësisht shumat: 1.530 USD në datën 28.5.2013; 564 USD në datën 2.8.2013; 617 USD në datën 6.12.2013; 517 USD në datën 8.4.2014; dhe 550 USD në datën 19.8.2015.

151. Lidhur me këto shuma të depozituara, nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarive bankare nuk është konstatuar ndonjë tërheqje e konsiderueshme as prej subjektit dhe as prej ish-bashkëshortit, por gjendjet e disponuara *cash* në banesë të deklaruara në vitet paraardhëse dhe tërheqjet e kryera nga llogaritë përkatëse të pagave duket se i mbulojnë shumat e depozituara.

152. Në përfundim të analizimit të mësipërm ka rezultuar se:

- Duket se gjendjet e deklaruara nga subjekti në deklaratën *Vetting* përputhen me dokumentacionin e administruar.
- Duket se është i konfirmuar burimi i krijimit të gjendjes në llogarinë në monedhën lekë, me të ardhurat nga qiradhënia – ndonëse nuk ka rezultuar e provuar ligjshmëria e tyre, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për të ardhurat e përfituara në periudhën prill – dhjetor të vitit 2014.
- Duket se subjekti ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për depozitimet e kryera në llogarinë në monedhën USD.

9. Gjendje *cash* në vlerën 1.400.000 lekë dhe analiza financiare e viteve përkatëse

153. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* gjendjen *cash* të disponuar në banesë, në vlerën 1.400.000 lekë. Siç është trajtuar edhe më sipër, duke u nisur nga shpjegimet e dhëna nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 3, por edhe nga deklarimi i subjektit në DIPP-në e vitit 2014, Komisioni ka përlllogaritur gjendjen e disponuar *cash*

në banesë, duke konsideruar shumën e deklaruar në fund të çdo viti si një shtesë të likuiditeteve totale të disponuara në çdo fund viti.

154. Në vijim të sa më sipër analizuar mbi gjendjen *cash* të disponuar në banesë, të cilat mund të mbuloheshin me burime të ligjshme financiare, ka rezultuar se pas depozitimit të shumës 15.000 euro (nga kursimet *cash*) në llogarinë e subjektit në OTP Bank në tetor të vitit 2016, shuma e mbetur prej këtyre kursimeve në fund të vitit 2016, me burime të ligjshme financiare, ishte 749.042 lekë.
155. Komisioni ka përlllogaritur gjithashtu mundësinë e kursimit nga të ardhura të mundshme gjatë periudhës 1.1.2017 – 27.1.2017, deri në dorëzimin e deklaratës *Vetting* dhe nga verifikimet e kryera në llogaritë bankare të subjektit janë konstatuar tërheqje të kryera prej saj në shumën totale prej 220.000 lekësh, nga të cilat pas zbritjes së shpenzimeve jetike për të njëjtën periudhë prej 17.259 lekësh⁶⁰ ka rezultuar se subjekti mund të krijonte kursime me burime të ligjshme financiare gjatë kësaj periudhe, në masën 202.741 lekë.
156. Nga sa më sipër, duket se gjendja e kursimeve të mundshme, të justifikuar me burime të ligjshme financiare, ka qenë në masën totale 951.783 lekë, nga ku duket se për të disponuar kursimet e pretenduara prej 1.400.000 lekësh në deklaratën *Vetting* subjekti ka pasur një mungesë prej 448.217 lekësh.
157. Duke filluar nga viti 2009 e deri në vitin 2014⁶¹, nuk ka rezultuar ndonjë investim i kryer prej familjes së subjektit të rivlerësimit në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, përveç krijimit dhe deklarimit të kursimeve në *cash*. Nga analiza financiare ka rezultuar se përgjatë periudhës 2009 – 2013 ka rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme financiare, në total prej 4.797.020 lekësh⁶², për të justifikuar të gjitha shpenzimet/pagesat dhe kursimet e pretenduara dhe pasqyruar të përmbledhura në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 3 – analiza e periudhës 2009 – 2013

Viti	2009	2010	2011	2012	2013
PASURI	657 640	270 816	614 534	263 482	530 324
Të ARDHURA dokumentuar	2 809 331	1 937 093	969 834	1 021 296	1 107 712
SHPENZIME	2 447 658	2 334 889	2 245 675	2 202 845	1 074 423
Rezultati i analizës financiare	-295 967	-668 612	-1 890 374	-1 445 031	-497 035
CASH në lekë	667 560	1 197 819	1 674 692	2 017 173	2 364 912

⁶⁰ Referuar të dhënave zyrtare të Anketës së Buxhetit të Familjes, në faqen zyrtare të INSTAT-it, shpenzimet e jetesës për frymë për vitin 2017 kanë qenë në masën 238.054 lekë. Shpenzimet përkatëse për periudhën e analizuar janë përlllogaritur nga Komisioni në mënyrë përpjesëtimore në raport me shpenzimet totale të vitit.

⁶¹ Pas kryerjes së pagesës së kështit të fundit të njësisë prej 3.600 euro, në nëntor të vitit 2008, analizuar kjo në trajtimin e pasurisë nr. 1, në përfundim të së cilës ka rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme financiare prej 920.276 lekësh, për të kryer të gjitha pagesat dhe shpenzimet e familjes gjatë atij viti.

⁶² Kjo mungesë nuk ka përfshirë balancën negative të rezultuar në vitin 2014, pasi është trajtuar veçmas në pasurinë nr. 5 të këtij relacioni.

158. Në përfundim të sa më sipër ka rezultuar se:

- Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën 448.217 lekë, për të realizuar kursimet e pretenduara prej 1.400.000 lekësh në deklaratën *Vetting*.
- Nga analiza financiare duket se për të mbuluar të gjitha shpenzimet/pagesat e kryera dhe për të realizuar kursimet e pretenduara, përgjatë periudhës 2009 – 2013, subjekti i rivlerësimit ka pasur pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare në shumën totale 4.797.020 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

159. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, ka kundërshtuar përlllogaritjet e analizës financiare nga Komisioni, pasi nëse ato do të kryheshin sipas saj do të kishte mundësi për kursimin e shumave në analizë – duke pretenduar konkretisht, si vijon:

a. Lidhur me vitin 2009:

- i. uljen e shpenzimeve të jetesës, duke konsideruar qytetin e Gjirokastrës si rajon malor, në të cilën shpenzimet janë më të ulëta;
- ii. saktësimin e shpenzimeve të udhëtimit për vitin 2009 (nga 1.151.794 lekë në 928.481 lekë), duke konsideruar për udhëtimet brenda ditës me destinacion Janinën, një kosto prej 20 euro, në vend të 25 euro; të konsiderohet kartoni jeshil 1-vjeçar në vend të atij 2-javor, duke qenë se udhëtimet janë të shpeshta; të sistemohen shpenzimet e transportit për udhëtimet me autobus me 15 euro për vajtje-ardhje në vend të shpenzimeve të naftës;
- iii. njohjen e të ardhurave nga qiradhënia e zyrës, sipas arkëttimeve në llogarinë bankare të bashkëshortit (270.000 lekë në vend të 180.000 lekë), për sa kohë referuar legjislacioneve në fuqi detyrimi për pagimin e tatimit në burim ka qenë i qiramarrësit;
- iv. është pretenduar se nga Komisioni nuk është pasqyruar një depozitë bankare në shumën 256.000 lekë e investuar në vitin 2009, duke mos u përfshirë në përlllogaritjet e shtesës së deklaruar prej subjektit në mjetet monetare.

b. Lidhur me vitin 2010:

- i. uljen e shpenzimeve të jetesës, duke konsideruar qytetin e Gjirokastrës si rajon malor, në të cilën shpenzimet janë më të ulëta;
- ii. saktësimin e shpenzimeve të udhëtimit për vitin 2010 (nga 1.062.217 lekë në 406.340 lekë), duke konsideruar për udhëtimet brenda ditës me destinacion Janinën, një kosto prej 20 euro, në vend të 25 euro; të konsiderohet kartoni jeshil 1-vjeçar në vend të atij 2-javor, duke qenë se udhëtimet janë të shpeshta; të sistemohen shpenzimet e transportit për udhëtimet me autobus me 15 euro për vajtje-ardhje në vend të shpenzimeve të naftës;
- iii. po ashtu, subjekti ka kërkuar që për 3 udhëtime të bashkëshortit të saj, të cilat rezultojnë me 66, 12 dhe 12 ditë, të llogaritura nga Komisioni në shumën totale 4.500 euro, të konsiderohet se ka qëndruar përkatësisht vetëm 3 ditë dhe 2 ditë dhe se nuk mund të penalizohet subjekti për mosfunksionimin apo mosregjistrimin e saktë në sistemin *TIMS*;

iv. njohjen e të ardhurave nga qiradhënia, bazuar dhe në kryerjen e pagesës në vitin 2021 të detyrimeve tatimore.

c. Lidhur me vitin 2011:

- i. uljen e shpenzimeve të jetesës, duke konsideruar qytetin e Gjirokastrës si rajon malor, në të cilën shpenzimet janë më të ulëta;
- ii. saktësimin e shpenzimeve të udhëtimit për vitin 2011 (nga 1.549.237 lekë në 600.823 lekë), duke konsideruar për udhëtimet brenda ditës me destinacion Janinën, një kosto prej 20 euro në vend të 25 euro; të konsiderohet kartoni jeshil 1-vjeçar në vend të atij 2-javor, duke qenë se udhëtimet janë të shpeshta; të sistemohen shpenzimet e transportit për udhëtimet me autobus, me 15 euro për vajtje-ardhje në vend të shpenzimeve të naftës;
- iii. po ashtu, subjekti ka kërkuar që për 4 udhëtime të vajzës dhe të bashkëshortit të saj, të cilat rezultojnë me 14, 8, 54 dhe 55 ditë, të llogaritura nga Komisioni në shumën totale 6.550 euro, të konsiderohet se kanë qëndruar nga 1 ditë dhe se nuk mund të penalizohet subjekti për mosfunksionimin apo mosregjistrimin në sistemin *TIMS*;
- iv. njohjen e të ardhurave nga qiradhënia, bazuar dhe në kryerjen e pagesës në vitin 2021 të detyrimeve tatimore;
- v. njohjen e të ardhurave të bashkëshortit nga punësimi në shoqërinë “K.” sh.p.k., ndonëse nuk ka rezultuar i siguruar përgjatë vitit 2011 dhe janë bërë përlllogaritjet e pagave *neto* në bazë të deklarimeve të subjektit mbi pagën *bruto*.

d. Lidhur me vitin 2012:

- i. uljen e shpenzimeve të jetesës, duke konsideruar qytetin e Gjirokastrës si rajon malor, në të cilën shpenzimet janë më të ulëta;
- ii. saktësimin e shpenzimeve të udhëtimit për vitin 2012 (nga 1.214.671 lekë në 955.769 lekë), duke konsideruar për udhëtimet brenda ditës me destinacion Janinën, një kosto prej 20 euro në vend të 25 euro; po ashtu subjekti ka kërkuar që për 3 udhëtime të vajzës dhe të bashkëshortit të saj, të cilat rezultojnë me 16, 16 dhe 6 ditë, të llogaritura nga Komisioni në shumën totale 1.900 euro, të konsiderohet se kanë qëndruar nga 1 ditë dhe se nuk mund të penalizohet subjekti për mosfunksionimin apo mosregjistrimin e saktë në sistemin *TIMS*;
- iii. njohjen e të ardhurave nga qiradhënia, ndonëse për këtë vit nuk kanë rezultuar të provuara pagesat e detyrimeve tatimore, por referuar legjislacionit në fuqi detyrimi për to ka qenë i qiramarrësit LSI;
- iv. moskonsiderimin e shpenzimit me kartë krediti prej 178.000 lekësh, pasi është pretenduar pagimi i biletave të udhëtimit të familjes së subjektit në SHBA dhe që janë përlllogaritur njëherë në shpenzimet e udhëtimit;
- v. njohjen e tërheqjes së depozitës prej 256.000 lekësh në “Raiffeisen Bank” dhe për rrjedhojë përfshirjen e saj në shtimin e kursimeve të deklaruara prej subjektit.

e. Lidhur me vitin 2013:

- i. uljen e shpenzimeve të jetesës, duke konsideruar qytetin e Gjirokastrës si rajon malor, në të cilën shpenzimet janë më të ulëta;
- ii. zbritjen e shpenzimeve të vajzës dhe të bashkëshortit përgjatë vitit, pasi me bashkëshortin ka zgjidhur martesën, ndërsa vajza jeton në SHBA;
- iii. saktësimin e shpenzimeve të udhëtimit për vitin 2013 (nga 514.455 lekë në 384.901 lekë), duke konsideruar për udhëtimet brenda ditës me destinacion Janinën, një kosto

prej 20 euro, në vend të 25 euro; po ashtu, subjekti ka kërkuar që për udhëtimet e bashkëshortit të saj në vitin 2013, të mos konsiderohen pasi ka qenë i ndarë nga familja;

iv. njohjen e të ardhurave nga qiradhënia, ndonëse për këtë vit nuk kanë rezultuar të provuara pagesat e detyrimeve tatimore, por referuar legjislacionit në fuqi detyrimi për to ka qenë i qiramarrësit LSI.

160. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një raport të kryer nga audituesi ligjor, i cili ka kryer llogaritjet për zëra të ndryshëm, si dhe ka paraqitur një mandatpagesë të datës 25.6.2021, për pagimin e tatimit mbi të ardhurat nga qiradhënia e zyrës, për vitet 2010 - 2011, në masën 72.000 lekë nga znj. Mirela Iliopullo.

Vlerësimi i trupit gjykues

161. Lidhur me vitin 2009, Komisioni i ka vlerësuar bindëse shpjegimet e subjektit, për sa i përket shpenzimeve për kartonin jeshil për një periudhë 1-vjeçare, si dhe shpenzimet për udhëtimet ditore me destinacion Janinën me 20 euro/dita në vend të 25 euro/dita, të përlllogaritura më herët. Nga shqyrtimi i udhëtimeve të vitit 2009 nuk ka rezultuar ndonjë udhëtim me autobus, por prej subjektit janë pretenduar udhëtimet pa automjet – më këmbë. Për sa kohë nuk është provuar dhe/ose nuk ka rezultuar kryerja e udhëtimeve me autobus, dhe duke u përjashtuar mundësia e një udhëtimi në këmbë/pa automjet, Komisioni i ka përlllogaritur shpenzimet përkatëse si udhëtime me automjet privat. Për më tepër që udhëtimi vajtje-ardhje me autobus kushton 15 euro, ndërkohë që shpenzimet e naftës me automjet janë 12-13 euro. Në përfundim, pasi janë marrë në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit, shpenzimet e udhëtimeve ndryshojnë me një pakësim, nga 1.151.794 lekë në 1.069.355 lekë.

162. Lidhur me të ardhurat nga qiradhënia, Komisioni ka përlllogaritur për vitin 2009 të ardhurat në masën 180.000 lekë, aq sa ka rezultuar i provuar edhe nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore prej qiramarrësit.

163. Lidhur me depozitën e pretenduar të pa përfshirë në analizë nga Komisioni, pasi u rishqyrtua dokumentacioni i administruar, ka rezultuar se kjo depozitë është në fakt në emër të babait të subjektit J. I. dhe jo të bashkëshortit të subjektit J. K., për rrjedhojë, nuk kishte se si të përfshihej në analizën e subjektit apo në shtesën e deklaruar mbi mjetet e saj monetare, për sa kohë nuk ka qenë person i lidhur dhe nuk janë përlllogaritur si të përbashkëta të ardhurat dhe shpenzimet përkatëse.

164. Po ashtu, lidhur me vitin 2010, Komisioni ka pranuar pretendimin lidhur me shpenzimin e përlllogaritur për kartonin jeshil për një periudhë 1-vjeçare, si dhe shpenzimet për udhëtimet ditore me destinacion Janinën me 20 euro/dita në vend të 25 euro/dita. Nga shqyrtimi i udhëtimeve të vitit 2010 nuk ka rezultuar ndonjë udhëtim me autobus, si dhe shpenzimi për vitin 2010 është 15 euro si me automjet dhe me autobus. Për pasojë e pranimit të këtyre pretendimeve mbi udhëtimet, si më sipër, rezultati financiar i vitit 2010 ndryshon nga -668.613 lekë në -37.446 lekë.

165. Lidhur me të ardhurat nga bursa e vajzës së subjektit, nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion shtesë provues mbi atë të përfituar në vitet 2008, 2010 dhe 2011, për rrjedhojë, duket se ato mbeten në nivel deklarativ, ndërkohë që Komisioni do të konsiderojë në analizën financiare bursat e dokumentuara si të ardhura të përfituara konkretisht.

166. Lidhur me të ardhurat nga qiradhënia e njësisë zyrë, siç është trajtuar edhe më sipër, rezulton se subjekti ka paguar detyrimet tatimore mbi të ardhurat e përfituara vitin 2010, vetëm pasi është njohur me rezultatet hetimit administrativ. Referuar orientimeve të KPA-së, pagesa e detyrimeve tatimore pas dorëzimit të deklaratës *Vetting* është e papranueshme në kuptimin e konsiderimit të burimit financiar të ligjshëm dhe nuk e shmang subjektin nga përgjegjësia ligjore, pasi nuk mund të zhbëjë qasjen e tij në kundërshtim me ligjin ndër vite, që u karakterizua nga mospagimi i detyrimeve tatimore në momentin dhe vitin përkatës kur ato duhej të shlyheshin. Për më tepër që, në rastin konkret, duket se subjekti ka vepruar për pagesën e detyrimeve tatimore të vitit 2010 vetëm me qëllimin e një burimi shtesë për të mbuluar pamundësinë e mjeteve monetare të konstatuar pikërisht nga rezultatet e hetimit, në tentativë për të legjitimuar një të ardhur që kishte realizuar 11 vite më herët.
167. Lidhur me pretendimet e subjektit për analizën financiare të vitit 2011, Komisioni sërish ka hequr shpenzimin e përllogaritur për kartonin jeshil për një periudhë 1-vjeçare, si dhe shpenzimet për udhëtimet ditore me destinacion Janinën janë rillogaritur me kosto 20 euro/dita në vend të 25 euro/dita, që ishin përllogaritur më herët. Për rrjedhojë e pranimit të këtyre pretendimeve, rezultati financiar i vitit 2011 ndryshon nga -1.890.374 lekë në -1.003.180 lekë. Lidhur me të ardhurat nga bursa e vajzës së subjektit, si dhe mbi të ardhurat e përfituara nga qiradhënia e njësisë zyrë, Komisioni vlerëson se sa është arsyetuar për vitet e 2009 e 2010, si më sipër, vlen edhe për vitin 2011.
168. Edhe për sa i përket vitit 2012, Komisioni ka pranuar heqjen e koston 1-vjeçare për kartonin jeshil të siguracionit për jashtë shtetit, si dhe shpenzimet për udhëtimet ditore me destinacion Janinën janë përllogaritur me 20 euro/dita në vend të 25 euro/dita. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga qiradhënia e njësisë zyrë, vlen sa më lart është arsyetuar.
169. Lidhur me shumën prej 256.000 lekësh të tërhequr nga llogaria në “Raiffeisen Bank”, është konstatuar se ajo i përket babait të subjektit J. I. dhe jo bashkëshortit të saj J. K., për rrjedhojë, kjo shumë nuk mund të konsiderohet si disponibilitet i subjektit, për sa kohë nuk është provuar mënyra dhe shkaku i përfitimit/disponimit të saj.
170. Lidhur me mospërllogaritjen e shpenzimeve të kartës së kreditit, pasi janë paguar biletat e avionit të cilat janë llogaritur si shpenzim në udhëtimin e familjes, Komisioni e vlerëson të besueshëm pretendimin e subjektit dhe, për rrjedhojë e pranon atë, duke zbritur nga shpenzimet zërin përkatës. Për rrjedhojë, pas pranimit të pretendimeve të subjektit lidhur me shpenzimin për biletat e avionit me kartën e kreditit dhe për shpenzimet e udhëtimeve të bashkëshortit, si më lart, rezultati përfundimtar i vitit 2012 ka ndryshuar nga -1.445.031 lekë në -1.019.727 lekë.
171. Lidhur me vitin 2013, Komisioni, gjithashtu ka pranuar pretendimet e subjektit mbi heqjen e koston 1-vjeçare për kartonin jeshil të siguracionit për jashtë shtetit, si dhe shpenzimet për udhëtimet ditore me destinacion Janinën janë përllogaritur me 20 euro/dita në vend të 25 euro/dita. Për sa i përket udhëtimeve të bashkëshortit të subjektit, Komisioni kishte përfshirë në analizë 3 udhëtime të tij gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2013, për sa kohë zgjidhja e martesës është bërë në shtator të vitit 2013. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga qiradhënia e njësisë zyrë edhe për këtë vit, vlen sa është argumentuar më sipër. Për sa i përket shpenzimeve të jetesës, Komisioni ka përllogaritur shpenzimet e bashkëshortit për 9 muaj dhe shpenzimet e vajzës për 3 muaj në Shqipëri, sipas periudhave që kanë rezultuar nga sistemi *TIMS* se ajo ka qenë në Shqipëri. Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar përbërjen familjare vetëm me vajzën e saj. Nisur

nga pranimi i pjesshëm i pretendimeve të subjektit, nga ripërlllogaritjet ka rezultuar se bilanci i vitit 2013, ndonëse mbetet në vlerë negative, ndryshon nga -497.035 lekë në -353.428 lekë.

10. Lidhur me shpenzimet për arsimimin e vajzës së subjektit në Greqi dhe në SHBA

172. Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura në masën 600 euro/muaj, të përfituara nga Ministria e Jashtme e Republikës së Greqisë, për të drejtën/bursën e studimit të vajzës në Greqi dhe të përdorura për shpenzimet e studimeve. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka bërë me dije se vajza e saj ka studiuar në Universitetin e Patrës deri në vitin 2010, vit në të cilin ka ndërprerë studimet në Greqi. Për sa më sipër lidhur me të ardhurat e përfituara, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë dokumentacionin ligjor që provon bursën e përfituar nga e bija, periudhën në të cilën janë përfituar këto të ardhura, si dhe shpenzimet përkatëse të studimeve.
173. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka shpjeguar se: *“Në lidhje me bursën e përfituar nga vajza kam paraqitur vërtetimin të përkthyer që M. K. ka qenë e trajtuar me bursë. Sqaroj se lidhur me shumën, me sa më kujtohet, kanë qenë standarde, kam kërkuar edhe informacion shtesë lidhur me këtë, por për shkak të pandemisë nuk mund të udhëtoj për marrje informacioni dhe kërkohet kohë më e gjatë”*. Së bashku me përgjigjen ajo ka vënë në dispozicioni librezën e studentit dhe një vërtetim⁶³ nga Ministria e Punëve të Jashtme⁶⁴, sipas së cilës vajza e saj ka marrë bursë nga Ministria e Jashtme për studime për periudhën 2008 – 2010, por nga shqyrtimin i përmbajtjes së këtij vërtetimi nuk është e përcaktuar qartësisht shuma e bursës së përfituar përgjatë kësaj periudhe.
174. Për të qartësuar këtë situatë, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, ka rifutuar subjektin të paraqesë dokumentacion provues mbi shumën konkrete të të ardhurave të përfituara nga bursa, ku në përgjigje të saj është shprehur se shuma e bursave të dhëna nga shteti grek janë standarde në shumën 600 euro/muaj, duke bërë me dije se kjo shumë mbulonte shpenzimet e jetesës së vajzës dhe të udhëtimit. Gjithashtu, ajo ka paraqitur edhe një vërtetim të datës 22.1.2013 të lëshuar nga Universiteti i Patrës, në të cilin është konfirmuar regjistrimi në vitin akademik 2008 – 2009, lëvizje në llogarinë bankare të shtetasës M. K. në Bankën Bujqësore të Greqisë, sipas së cilave janë përfituar përkatësisht shumat: 3.600 euro në datën 15.5.2009; 1.800 euro në datën 3.7.2009; dhe 1.800 euro në datën 13.10.2009, ndonëse këto lëvizje të paraqitura nuk përmbajnë ndonjë firmë apo vulë të institucionit lëshues.
175. Komisioni i ka përllogaritur në këtë fazë të ardhurat e provuara të përfituara përgjatë vitit 2009, të cilat në total arrijnë në shumën 7.200 euro, e cila përputhet me shumën e pretenduar prej 600 euro/muaj. Po ashtu, Komisioni ka përllogaritur në analizën financiare shpenzimet e jetesës së vajzës së subjektit në shtetin grek për periudhën tetor 2008 – shkurt 2011, si të barabarta me vlerën e bursës së përfituar prej saj nga Ministria e Jashtme, për sa kohë – referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁶⁵ – bursa akordohet dhe konsiderohet si një ndihmë financiare për të përballuar pikërisht shpenzimet për ushqim dhe shpenzime të tjera të vogla të studentit, të cilat hyjnë si shpenzime bazë jetese. Për më tepër, edhe referuar të dhënave zyrtare të Eurostat-it,

⁶³ Në gjuhën greke, përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar.

⁶⁴ Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit të Zhvillimit Ndërkombëtar.

⁶⁵ Vendim nr. 9/2018 (JR), datë 24.10.2018, përfshirë mendimin paralel, subjekti i rivlerësimit A. Xh., ku shprehet se

shpenzimet e jetesës në shtetin grek, përgjatë kësaj periudhe, janë pothuajse në të njëjtat nivele me shumat e përfituara nëpërmjet bursave në analizë.

176. Lidhur me studimet në SHBA në vitet 2012 - 2016, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti është shprehur se nga viti 2012 vajza e saj është larguar në New Jersey, SHBA, ku dhe ka vazhduar studimet, fillimisht në B. C. C. dhe më pas në F. D. U., dhe se shpenzimet e jetesës janë përballuar nga i fejuari i saj, shtetasi D. B.. Për të provuar këtë ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 9.3.2021, në të cilën ka deklaruar se prej vitit 2012 e në vijim ai ka jetuar së bashku me të fejuarën e tij në SHBA dhe se ka mbuluar të gjitha shpenzimet për shkollimin dhe jetesën.
177. Komisioni, nëpërmjet pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 3, i ka kërkuar subjektit të bëjë me dije mbi shpenzime të mundshme të shkollimit të vajzës në secilën prej institucioneve arsimore të sipërpërmendura, si dhe shpenzimet e jetesës. Në përgjigje të sa më sipër, ajo ka bërë me dije se studimet e së bijës janë përballuar nga ndihma financiare nga shteti amerikan, duke qenë nënshtetase amerikane dhe se ka përfituar rimbursim sipas rregullave standarde të SHBA-së.
178. Për të provuar sa ka shpjeguar, subjekti ka paraqitur dokumentacionin si vijon:
- i. Raport i detajuar mbi shpenzimet e shkollimit për secilin semestër të B. C. C. për shtetasen M. K., në të cilin janë evidentuar pagesat konkrete të kryera nga ndihma financiare nga vetë studenti, si dhe rimbursimet e përfituara; kartela e llogarisë së studentes M. K. nga F. D. U., në të cilin janë detajuar shpenzimet e shkollimit për secilin semestër, duke u evidentuar pagesat konkrete të kryera nga ndihma financiare dhe nga vetë studenti.
 - ii. Vërtetim i datës 11.12.2019, lëshuar nga F. D. U., në të cilin është konfirmuar se vajza e subjektit ka ndjekur studimet në këtë universitet gjatë periudhës gusht 2015 – shkurt 2018 dhe gjatë kësaj kohe i është akorduar ndihmë financiare shtetërore dhe institucionale në formën e granteve, bursave dhe kredive për të mbuluar shpenzimet.
179. Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të pretenduara si të mbuluara nga bashkëshorti i vajzës, Komisioni i ka kërkuar gjithashtu subjektit të bëjë me dije mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave të të fejuarit të vajzës, shtetasit D. B., që kanë mundësuar mbulimin e shpenzimeve të shkollimit dhe të jetesës në SHBA. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti është shprehur se burimet e ligjshme të të ardhurave të tij kanë qenë dhuratë nga i ati, shtetasi R. B., të cilat janë transferuar nëpërmjet bankës ose Western Union. Për të provuar sa më sipër, subjekti ka paraqitur disa transferta të kryera nga shtetasi R. B.⁶⁶ në favor të djalit të tij, të cilat kanë rezultuar në shumën totale 31.350 USD (të konvertuara në 3.289.777 lekë), përgjatë periudhës shtator 2011 – maj 2013. Në këto transferta është konstatuar se përshkrimi ka qenë për pagesë të studimeve dhe të qirasë së djalit të tij. Në vijim, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, i ka kërkuar subjektit të bëjë me dije mbi institucionin arsimor në të cilin ka studiuar i fejuari i vajzës, si dhe shpenzimet e tij për shkollimin dhe qiranë. Subjekti, në përgjigjet e saj, është shprehur se ky i fundit nuk ka ndjekur studime në SHBA, përveç kurseve të gjuhës dhe kurseve profesionale pa pagesë, si dhe ka paraqitur kartelën e detajuar të pagesave të qirasë të kryera, duke filluar nga viti 2011 e në vijim.

⁶⁶ Përveç transfertave nga z. R. në favor të djalit të tij, janë konstatuar disa prej transfertave të kryera nga shtetasi K. D., për të cilin nuk është e provuar lidhja, si dhe një transfertë e dërguar nga shtetasi Y. Sh. në favor të shtetasit R. B.. Për rrjedhojë, këto shuma nuk janë përllogaritur në analizën e kryer.

180. Më tej, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, Komisioni i ka kërkuar sërish subjektit të bëjë me dije mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait të të fejuarit të vajzës së saj, që kanë mundësuar mbulimin e shpenzimeve. Në vijim të kësaj kërkesë, subjekti ka paraqitur, së bashku me përgjigjet e saj, dokumentacionin, si vijon:
- i. deklaratë noteriale nr. ***, datë 16.4.2021, të lëshuar nga shtetasi R. B., i cili ka deklaruar se të ardhurat nga shitja e truallit, nga qiradhënia e karburantit në Gjirokastër dhe transferta e bërë nga shtetasi A. G. në vitin 2011 janë përdorur për financimin e djalit dhe familjes së tij në SHBA;
 - ii. kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 26.3.2003, për shitjen e një pasurie të paluajtshme të llojit “truall”, të shtetasit R. B., shoqërisë “F.” sh.p.k., kundrejt çmimit 3.900.000 lekë;
 - iii. kontratë qiraje (e panoterizuar) e datës 1.5.2008, me afat 5-vjeçar, e lidhur midis qiradhënësit R. B. dhe qiramarrësit “F.” sh.p.k., për dhënien me qira të pasurisë së paluajtshme me nr. ***, kundrejt çmimit 100.000 lekë *neto*/muaj;
 - iv. kontratë qiraje (e panoterizuar) e datës 22.3.2013, me afat 5-vjeçar, e lidhur midis qiradhënësit R. B. dhe qiramarrësit “F. P.” sh.p.k., për dhënien me qira të pasurisë së paluajtshme me nr. ***, kundrejt çmimit 100.00 lekë *neto*/muaj;
 - v. lëvizjet bankare të llogarisë në BKT të shtetasit R. B., sipas të cilës në datën 3.2.2011 është transferuar në favor të tij nga shoqëria “O. P.” sh.p.k., shuma prej 10.000.000 lekësh, me përshkrimin “ndihmë financiare”. Nga kjo shumë është kryer një pagesë prej 8.250.000 lekësh në favor të DRT-së Sarandë dhe shuma prej 1.400.000 lekësh është tërhequr *cash*.
181. Komisioni ka kryer gjithashtu hetime në internet dhe në faqet zyrtare të institucioneve statistikore në SHBA, për të përcaktuar nivelin e shpenzimeve të jetesës në këtë shtet. Nga kërkimet në internet⁶⁷, Komisioni ka marrë në konsideratë shpenzimet e jetesës më të ulëta (niveli i varfërisë) për dy persona⁶⁸. Nga përlllogaritjet e kryera nga Komisioni, duke konsideruar vetëm periudhën që vajza e subjektit ka qëndruar⁶⁹ në SHBA, ka rezultuar se për periudhën 2011⁷⁰ – 2016 shpenzimet për jetesën dhe shkollimin e vajzës dhe të jetesës së të fejuarit të saj kanë qenë në masën 15.138.299 lekë, nga të cilat 9.957.070 lekë kanë qenë pjesa takuese e të fejuarit dhe 5.181.230 lekë e vajzës së subjektit.
182. Subjekti ka paraqitur, së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, deklaratat vjetore të të ardhurave të të fejuarit të vajzës, për periudhën 2015 – 2018, nga analizimi i të cilave ka rezultuar se të ardhurat e tij nga vetëpunësimi në SHBA, për periudhën në analizë 2015 – 2016, kanë qenë 523.150 lekë⁷¹. Ndërkohë, nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur prej subjektit lidhur me burimin e ligjshëm të babait të të fejuarit të vajzës në kontratat e

⁶⁷ [cpsmar19.pdf \(census.gov\)](#)

⁶⁸ Duke qenë se shpenzimet e qirasë së vajzës së subjektit dhe të fejuarit të saj janë të dokumentuara, Komisioni ka zbritur nga shpenzimet totale vjetore të përcaktuara për nivelin e varfërisë në SHBA, duke shtuar shpenzimet konkrete të përballuara prej tyre për qiranë e banesës. Hapësirën që zënë shpenzimet e shtëpisë në shpenzimet totale të jetesës, për dy persona nën 65 vjeç, Komisioni e ka konsideruar në masën 27.3%, duke u bazuar në Anketën e Buxhetit të Familjes në Bergen, New Jersey, në linkun <https://www.epi.org/publication/family-budget-calculator-documentation/>.

⁶⁹ Për periudhën e qëndrimit në Shqipëri janë konsideruar shpenzimet në analizën financiare të subjektit, sipas të dhënave zyrtare të INSTAT-it, për aq muaj sa ka qenë qëndrimi në raport me shpenzimet totale të jetesës së vitit.

⁷⁰ Për vitin 2011 janë konsideruar vetëm shpenzimet për një periudhë 4-mujore, të cilat i përkasin periudhës gjatë së cilës janë transferuar shumat nga babai i të fejuarit të vajzës së subjektit, nga shtatori i vitit 2011 e në vijim.

⁷¹ Pas taksave, të cilat janë konsideruar të paguara në vitin pasardhës, pas plotësimit të deklaratave.

qirasë⁷² së paraqitura, ndonëse është specifikuar se detyrimet ndaj shtetit, si tatimi në burim, do të paguhen nga qiramarrësit, nuk është provuar përfitimi i tyre dhe pagimi i detyrimeve tatimore.

183. Lidhur me shumën e mbetur nga transferta ndihmë financiare, prej 1.400.000 lekësh, mbetet i paprovuar burimi i ligjshëm i të ardhurave të shoqërisë “O. P.” sh.p.k. për shumën e transferuar në formën e ndihmës financiare. Këto të ardhura nga qiradhënia dhe nga ndihma financiare nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, pasi mungon destinimi dhe përfitimi i tyre prej djalit dhe nuk është i provuar burimi i ligjshëm i tyre. Edhe nëse do të provoheshin dhe do të konsideroheshin në analizë, së bashku me të ardhurat nga shitja e pasurisë së llojit “trual” prej 3.900.000 lekësh në vitin 2003, pas zbritjes së shpenzimeve jetike për të, duket se nuk mjaftojnë as për të mbuluar shpenzimet e të birit në SHBA. Për më tepër, nga shqyrtimi i deklaratave periodike të subjektit të rivlerësimit nga viti 2012 e deri në vitin 2016, nuk ka rezultuar ndonjë deklaram nga vajza e saj në deklaratën e personit të lidhur, të ndonjë dhurimi apo mbulimi të shpenzimeve të saj nga babai i të fejuarit, çka është pretenduar për herë të pare nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit.
184. Për rrjedhojë të sa më sipër, Komisioni ka konsideruar si burim të ligjshëm rimbursimet e përfituara nga vajza e subjektit, nga ndihma financiare për studimet, të cilat, nga dokumentacioni i administruar, kanë rezultuar në shumën ekuivalente prej 608.667 lekësh⁷³ dhe ka shtuar në analizë edhe shumat e dërguara nga subjekti në llogari të vajzës në SHBA nga llogaritë e saj bankare, në shumën totale prej 822.408 lekësh. Në përfundim të analizës së zërave të sipërpërmendur, ka rezultuar se vajza e subjektit ka pasur pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare, për përballimin e shpenzimeve të jetesës dhe studimeve në SHBA, në masën 3.750.154 lekë, siç është detajuar në tabelën në vijim.

Tabela nr. 4 – analiza e burimeve për mbulimin e shpenzimeve në SHBA

Rimbursime të kolegjit	608 667
Para të dërguara nga SR	822 408
Shpenzime jetese të vajzës së subjektit	- 5 181 230
Rezultati	- 3 750 154

185. Komisioni ka ftuar gjithashtu subjektin të japë shpjegime lidhur me mosdeklarimin e shpenzimeve të studimit dhe të jetesës së të bijës në SHBA, në deklaratat përkatëse periodike ndër vite. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti është shprehur se nuk kanë qenë shpenzime të saj dhe për pasojë nuk kishte çfarë të deklaronte dhe se çdo përfitim dhe çdo detyrim për të bijën dhe të fejuarin e saj vjen për shkak të shtetësisë së tyre amerikane dhe përmbushet po në atë shtet.
186. Nga sa më sipër, në përfundim të analizimit të sa më sipër, ka rezultuar se:

⁷² Në ekstraktin historik të shoqërisë “F.” sh.p.k., është konstatuar regjistrimi i adresës së pasurisë si selia e shoqërisë, në maj të vitit 2011 dhe çregjistrimi i saj në mars të vitit 2013.

⁷³ Përkatësisht 1.833 USD dhe 260 USD në vitin 2013; 1.761 USD në vitin 2014 dhe 1.534 USD në vitin 2015.

- Duket se subjekti i rivlerësimit dhe vajza e saj nuk kanë deklaruar në DIPP-të e viteve 2012 - 2016 shpenzimet dhe as dhurimet e përfituara për mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe të shkollimit të kësaj të fundit në SHBA gjatë kësaj periudhe.
- Duket se vajza e subjektit të rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën 3.750.154 lekë, për të përballuar shpenzimet e jetesës dhe të studimeve në SHBA.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

187. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionet e arritura nga Komisioni, duke sqaruar se edhe sipas sqarimeve të dhëna më herët, as ajo dhe as vajza e saj nuk kanë arkëtuar dhe nuk kanë paguar ndonjë shumë për shpenzimet e qëndrimit, por se këto shpenzime paguheshin direkt nga i fejuari i vajzës.
188. Pasaktësia në mosdeklarimin e dhurimeve të përfitimeve për mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe shkollimit të vajzës në SHBA, në kushtet kur këto të ardhura janë tërësisht të ligjshme, nuk mund të shërbejë si një gjetje për marrjen e masës disiplinore, si një qëndrim i mbajtur tashmë dhe i unifikuar i trupave të vlerësimit dhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Apelit, se deklarimet e pasakta të pasurisë ndër vite nuk mund të jenë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit⁷⁴.
189. Gjithashtu, për të provuar mundësinë financiare për të përballuar shpenzimet nga i fejuari i vajzës së saj, subjekti ka vënë në dispozicion deklaratën noteriale të shtetasit A. G., si dhe të dhënat bankare të këtij të fundi, nga ku rezulton se i ka dhuruar shtetasit R. B., vjehri i vajzës së subjektit, shumën 71.200 euro, e cila ka shërbyer për të përballuar shpenzimet e shkollimit të djalit dhe të fejuarës së tij.

Vlerësimi i trupit gjykues

190. Trupi gjykues, nisur nga pretendimet, argumentimet dhe dokumentacioni i paraqitur nga subjekti, i vlerëson ato jo bindëse dhe shteruese lidhur me burimet e ligjshme që mund të jenë përdorur prej personave të tretë për përballimin e shpenzimeve jetike dhe të shkollimit të vajzës së saj në SHBA. Ndërkohë që as vetë familja e subjektit nuk ka pasur mjaftueshmëri të mjeteve financiare për të financuar shpenzimet e vajzës së tyre – fakt ky që as nuk është pretenduar nga subjekti, për sa kohë është shprehur se nuk ka shpenzuar asgjë për të bijën pas largimit të saj në SHBA. Gjithashtu, edhe nga analizimi i provave të paraqitura, vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe vajza e saj si person i lidhur, që mbart detyrimin për deklarim sipas ligjit, nuk kanë deklaruar në DIPP-të e viteve 2012 – 2016 as shpenzimet dhe as dhurimet e pretenduara si të përfituara për mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe të shkollimit në SHBA.
191. Nga ana tjetër, trupi gjykues vlerëson se jo vetëm që nuk është provuar mjaftueshmëria e mjeteve financiare me burim të ligjshëm të përdorura për shpenzimet jetike dhe të shkollimit të vajzës së subjektit, por shpjegimi i dhënë së fundmi nuk duket bindës, për sa kohë rezulton pa sens logjik dhe pa një shkak të besueshëm fakti që shtetasi A. G. t'i dhurojë shtetasit R. B. – asokohe babai i të fejuarit të vajzës së subjektit – shumën prej 71.200 euro, për të përballuar shpenzimet e shkollimit të djalit dhe të fejuarës së tij. Për më tepër që kalimi i këtyre shumave në disponibilitetin e këtyre të fundit nuk është

⁷⁴ Subjekti ka parashtruar vendimin nr. 207/2019, të Komisionit, në të cilin arsyetohet se: “Në këtë analizë Komisioni çmon se pasaktësitë në deklarime nuk mund të konsiderohen si shkelje të asaj mase të cilat mund të shërbejnë si masë për shkarkimin nga detyra”.

provuar. Ndërkohë që Komisioni, në përlllogaritjet e kryera, ka përfshirë të gjitha transfertat që shtetasi R. B. kishte transferuar në drejtim/favor të djalit të tij dhe ka rezultuar se të ardhurat e provuara me burim të ligjshëm nuk mjaftonin as për të përballuar shpenzimet e të fejuarit, duke mbetur pa burime të ligjshme mjetet monetare të përdorura nga/për vajza/ën e subjektit të rivlerësimit në SHBA.

192. Nisur nga sa më sipër është analizuar, lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit për kryerjen e shpenzimeve të jetesës dhe të studimit në SHBA të vajzës së subjektit të rivlerësimit, në mungesë të burimeve alternative, për sa kohë pretendimet e subjektit mbetën të paprovuara, përfundimisht trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare, së paku në masën 3.750.154 lekë dhe për sa kohë nuk janë deklaruar as kryerja e as burimet përdorura për këto shpenzime, subjekti ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe të paplota në vitet përkatëse, duke shmangur kontrollin e tyre nga organet kompetente.

REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

193. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike të subjektit ndër vite, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, në aneksin nr. 1 që i bashkëngjitet këtij dokumenti, janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për çdo vit për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
194. Në këtë analizë, janë paraqitur, përlllogaritur dhe analizuar:
- i. Pasuritë e realizuara nga subjekti i rivlerësimit, të pasqyruara në vitin përkatës të kryerjes së investimit, me vlerën e përcaktuar në dokumentacionin përkatës të kontratave të shitblerjeve, mandatpagesave apo deklarimeve të subjektit.
 - ii. Të gjitha të ardhurat e deklaruara ndër vite dhe të ardhurat e dokumentuara, bazuar në përgjigjet e institucioneve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dhe/apo në përgjigje të pyetësorëve. Për të ardhurat nga qiradhënia, sa i përket ligjshmërisë së tyre në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, referojuni në pikën 1.3 të këtij relacioni.
 - iii. Shpenzimet jetike në Shqipëri janë përlllogaritur në bazë të frymëve (sipas periudhave të ndryshme të qëndrimit të anëtarëve të familjes), bazuar në të dhënat zyrtare të INSTAT-it.
 - iv. Shpenzimet e udhëtimit janë përlllogaritur duke u bazuar në raportin e hyrje-daljeve, sipas sistemit *TIMS*, bazuar në vendimin nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, të KPA-së dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve. Për udhëtimet në të cilat subjekti ka deklaruar qëndrim tek të afërmit, por deri në këtë fazë të hetimeve nuk ka paraqitur dokumentacion provues, Komisioni i ka konsideruar si udhëtime turistike.
 - v. Gjendja e likuiditeteve nënkupton gjendjen në fund të çdo viti të ndodhur në të gjitha llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit. Për gjendjen *cash* të disponuar në banesë, referojuni detajimit dhe analizimit të këtij zëri në pikat 7 dhe 9 të relacionit.
 - vi. Detyrimet përfshijnë gjendjen në fund të vitit të të gjitha detyrimeve të subjektit të rivlerësimit ndaj bankave të nivelit të dytë.

- vii. Kursi i këmbimit i përdorur për të gjitha investimet/shpenzimet/gjendjet bankare në valutë është konsideruar kursi mesatar i fundit të vitit, në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë⁷⁵.
- viii. Nga kjo analizë financiare, ku janë konsideruar, përlogaritur dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2003, vit në të cilin ka nisur edhe deklarimi i pasurisë nga ana e subjektit të rivlerësimit, pranë ILDKPKI-së, - bazuar në të dhënat e disponuara/administruara nga Komisioni, përgjatë fazës hetimore, - ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm negativ në masën – 8.523.143 Lekë, për të mbuluar të gjitha shpenzimet/pagesat dhe investimet e familjes së subjektit të rivlerësimit, të deklaruara dhe/ose të konstatuara, siç është detajuar në tabelën që vijon, si dhe – 3.750.154 Lekë për të mbuluar shpenzimet e jetesës dhe shkollimit të vajzës së saj në SHBA.

Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016:

Viti	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	68.136	4	690.945	1.321.971	294.118	913.570	657.640	270.816	614.534	263.482	530.324	4.857.492	427.628	-351.237
Truaill 600 m2 në Dropull të Poshtëm (b/sh), pajegjistruar	68.136													
Truaill 400 m2 në Sarandë, pajegjistruar në ZRPP														
Truaill 367,8 m2 në Sarandë (b/sh)														
Automjet tip Benz (b/sh) me targë SR***B														
Automjet me targë GJ***A			520.966											
Njësi me sipërfaqe 44,99 m2, Gjirokastër				667.996	1.088.190	443.457								
Kullotë me sipërfaqe 609 m2 në Kakavijë								63.336						
Apartament me sipërfaqe 98 m2 në Gjirokastër												4.200.000		
Ndryshim likuiditeti	0	4	169.979	653.975	-794.072	470.113	657.640	207.480	614.534	263.482	530.324	657.492	427.628	-351.237
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	0	4	169.983	823.958	29.887	500.000	1.157.640	1.365.120	1.979.654	2.243.136	2.773.460	3.430.952	3.858.581	3.507.344
DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Overdraft në Societe Generale - 300.000 Lekë														
PASURI NETO	68.136	4	690.945	1.321.971	294.118	913.570	657.640	270.816	614.534	263.482	530.324	4.857.492	427.628	-351.237
Të ARDHURA dokumentuar	909.075	1.220.025	1.479.835	1.046.734	949.874	1.307.824	2.809.331	1.937.093	969.834	1.021.296	1.107.712	1.407.530	1.730.144	1.677.510
Të ardhura të SR të vërtetuara	576.843	884.380	885.711	910.838	949.874	1.307.824	1.474.987	1.001.053	969.834	1.021.296	1.107.712	1.407.530	1.730.144	1.677.510
Të ardhura të B/sh të vërtetuara	332.232	335.645	594.124	135.896	-	-	346.720	936.040	-	-	-	-	-	-
Të ardhura të vajzës të vërtetuara							987.624							
SHPENZIME	281.592	281.592	332.279	310.192	476.468	1.288.173	2.365.219	1.703.722	1.358.480	1.777.541	1.058.299	839.041	973.220	953.611
Shpenzime jetese	281.592	281.592	328.671	264.763	307.721	375.705	273.240	273.240	273.240	317.304	282.048	366.663	299.035	333.047
Shpenzime për lidhjet e kontratave të njësise (ujë/drita etj)						13.740								
Shpenzime jetese për vajzën në Greqi/USA						221.729	987.624	999.432	165.960	430.511	276.221		181.130	
Shpenzime jetese për bashkeshortin në Greqi														
Shpenzime mobiliari/arredimi						50.000	35.000			35.000				
Shpenzime mjekësore														
Shpenzime udhëtimi				45.429	168.746	573.599	1.069.355	431.050	662.090	967.366	498.331	472.377	493.055	620.564
Shpenzime për tokat						53.400			231.626					
Shpenzime për kartën e kreditit									25.564	27.360	1.699			
Shpenzime transporti të automjeteve			3.608											
Rezultati i analizës financiare	559.347	938.429	456.611	-585.429	179.288	-893.919	-213.528	-37.446	-1.003.180	-1.019.727	-480.911	-4.289.003	329.295	1.075.136
CASH në lekë				750.000	0	356.957	667.560	1.197.819	1.674.692	2.017.173	2.364.912	2.972.676	3.672.977	1.492.509
DIFERENCA E PA MBULUAR	-8.523.143													

195. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit – përpos shpjegimeve jo bindëse dhe pretendimeve që mbeten në nivel deklarativ, ndonëse ka tentuar të paraqesë disa prova indirekte – ka dështuar të provojë me dokumentacion ligjor dhe me vlerë të plotë provuese burime të ligjshme alternative dhe shtesë, përtej atyre të konstatuara e të konsideruara si të tilla nga Komisioni përgjatë hetimit administrativ.

196. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni vlerëson se për sa i takon kriterit të pasurisë, bazuar në analizën financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, subjekti i rivlerësimit, znj. Mirela Iliopullo/Kore, nuk ka pasur burime të ligjshme financiare të mjaftueshme, sipas përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për të kryer të gjitha investimet e konstatuara dhe, njëkohësisht, për të përbaluar shpenzimet apo për të realizuar kursimet e deklaruara dhe shpenzimet e shkollimit të vajzës, si dhe ka kryer

⁷⁵ www.bankofalbania.org

fshehje të pasurisë, dhe bazuar në germat “b” dhe “c”, të pikës 5 të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, duhet të aplikohet pika 3 e nenit 61 e këtij ligji.

197. Nisur nga ky rezultat financiar, trupi gjykues nuk e konsideron të nevojshme analizimin e të gjitha pikave të tjera të rezultateve të hetimit apo kriteret e tjera, pasi referuar problematikave që kanë rezultuar lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme, deklaratimet e pasurive të pamjaftueshme dhe duke fshehur pasurinë – rezultatet e njoftuara për të cilat nuk u provua e kundërta mjaftojnë për aplikimin e masës disiplinore, duke i bërë të panevojshme elementet e tjera.
198. Në konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: (i) ka pasur mungesë të theksuar të burimeve financiare të ligjshme – sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës – për të kryer të gjitha investimet dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet apo për të realizuar kursimet e deklaruara; (ii) ka kryer në mënyrë të përsëritur deklarime të pamjaftueshme dhe ka fshehur pasurinë; (iii) kësaj duke cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Për rrjedhojë, subjekti nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e deklaratimit të pasurisë dhe duhet të aplikohet pika 5 e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikat 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
199. Në këto kushte, trupi gjykues, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin se subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Iliopullo/Kore, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, duhet t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Iliopullo, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 13.7.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona Sanxhaktari
Kryesuese

Xhensila Pine
Anëtare

Lulzim Hamitaj
Relator

Sekretare gjyqësore
Orjanda Liçi